

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7578 E mërkurë 4 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Reporter.al"
Cfarë është "sundimi i ligjit"?
Gjatë dekadave të fundit ne kemi dëgjuar shpesh se kriteri kryesor për integrim në Bashkimin Europian është që të kesh ...
Vijon në faqen 20

Nga GJERGJ EREBARA
Sundimi me ligje speciale është e kundërta e sundimit të ligjit



Opinion i Ditës
Mbarimi i maturës për gimnazistët përkon edhe me zgjedhjen e universitetit ku do të kryejnë studimet e larta. Një zgjedhje kjo, jo e lehtë, duke menduar ...
Vijon në faqen 21



Nga DORINA GJIPALI
Diplomat e "Luarasit", një pasaportë e fortë punësimit



FOTOT/ Kush janë shqiptarët e arrestuar

Shkatërrohet banda e trafikut të kokainës, 22 veta në pranga

Droga vinte nga Holanda, shpërndahet në jug të Italisë. Skema, si funksiononte grupi

ITALI- Policia italiane ka shkatërruar një bandë shqiptaro-arabe që merrej me trafikimin e kokainës nga Holanda për në Itali. Mësohet se gjatë operacionit "Sottobosco", që u krye mëngjesin e djeshëm në zonën e Emilia Romanjas dhe Toskanës u bënë mundur shkatërrimi i bandës shqiptaro-arabe, që kishte shtrirje në disa zona të Italisë ...

Në faqen 12

EMRAT/ QEVERIA MIRATON TE DREJTEN MBI TRUALLIN PER NDERTIMET PA LEJE

LEGALIZIMET, PRONESIA E TOKES PER 600 FAMILJE

Lista me përfituesit në të gjithë vendin, llogariten sipërfaqet takuese për secilin pronar. Vlera e shpërblimit, sa do kompensohen ish-pronarët



(Në foto) Toka të zëna nga ndërtime pa leje

Në faqen 10-11

VETINGU

Arta Marku drejt konfirmimit, KPK: Nuk ka shkelje apo fshehje të pasurisë

Në faqen 6

SOCIALE

Susta të dala dhe lagështirë, ja fotografitë nga "Qyteti Studenti"

Në faqen 9

PROVOKIMI I GREKVE

Kamenos: Çamët janë kriminelë. Mesila Doda: Je pasardhës i Zervës

Në faqen 4

"SHOW-BIZZ"

"I dashur kirurg plastik", kush janë VIP-at që kanë ndryshuar pamjen

Suplement

REPORTAZH



Turistët e huaj: Shqipëria, vend fantastik. 'Prestige Resort', perfekt

Në faqen 18

Pasuesja e Donald Lu, zv.ndihmës-sekretarja në Byronë e Europës në DASH

Trump emëron ambasadorin e re të SHBA në Tiranë

Kush është Kathleen Ann Kavalec, 30 vite eksperiencë në diplomaci

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump ka nominuar emrin e Kathleen Ann Kavalec, si ambasadore fuqiptë në Shqipëri. Kjo e fundit, nëse merr miratimin nga Senati, pritet të zëvendësojë ambasadorin aktual Donald Lu, të cilin i përfundoi



mandati dhe do të largohet nga Tirana. Kathleen Ann Kavalec aktualisht shërben si zëvendësndihmës Sekretare në Byronë e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike në Departamentin Amerikan të Shtetit dhe ka mbi tri dekada përvojë si diplomate ...

Në faqen 7

SITUATA POLITIKE DEBATET

Kreu i PD citon Salvinin për betejën antimafie: Erë ndryshimi edhe nga kjo anë e Adriatikut

Basha: Ndryshimi po vjen, fund mafies dhe narkoshtetit të Ramës

"Përballja me të keqen, deri në fitore"

Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha përcolli dje një mesazh të fortë për mafien, duke thënë se koha e ndryshimit po vjen dhe se opozita nuk do të ndalet përballjen me narkoshtetin deri në fitoren e demokracisë. Shpallja e luftës ndaj mafies nga ana e qeverisë italiane duket se ka shërbyer si frymëzim edhe për kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Ai rishpërndau një status në "Twitter" të Matteo Salvinin, ministër i Brendshëm i Italisë dhe lideri i Lega-s. "Koha e mafies ka stërpërfunduar! Tani duhet të demonstrojmë se shteti është më i fortë. Dua të kujtohem, në fund të udhëtimit, si njëri që më shumë se të tjerët luftoi Camorrën, 'Ndrangheta-n dhe mafien, duke u angazhuar në një turne, rajon pas rajoni", shkroi Salvinin në "Twitter", në orët e para të mëngjesit të së martës. Deklarata e Salvinin u shpërndau në "Twitter" nga kreu i PD-së, Basha, duke e konsideruar atë si "era e ndryshimit". "Mirëse vjen 'Era e Ndryshimit', Matteo Salvinin! Shumë shpejt edhe nga kjo anë e Adriatikut. Mafia shqiptare dhe Rama, që drejtojnë narkoshtetin, duhet të ndjehet 'nxehtësinë' nga Italia, në vend të gënjeshtreve, marrëveshjeve dhe fshehjeve të së shkuarës", shkruan kreu i PD-së, Lulzim Basha.

MESAZHI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha siguroi dje shqiptarët se opozita nuk do të ndalet përballjen me të keqen deri në fitoren e demokracisë në vend. Basha kujtoi edhe njëherë takimin që zhvilloi së fundmi me një grup të rinjsh, në kuadër të 2 korrikut të 1990, datën në të cilën 28 vite më parë, qytetarë të Tiranës hynë në Ambasadën Gjermane duke paralajmëruar fundit e regjimit diktatorial.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

LULZIM BASHA

Kreu i opozitës, Lulzim Basha përcolli dje një mesazh të fortë për mafien, duke thënë se koha e ndryshimit po vjen. "Mafia shqiptare dhe narkoshteti i Ramës duhet të ndjehet presionin e Italisë, në vend të gënjeshtreve, marrëveshjeve të fshehta dhe mbulimit të realitetit të deridjeshëm...", shkruan Basha në "Twitter".

Bushati, Bashës: Komenti yt, i pashpjegueshëm

Pas deklaratës së kreut të PD, Lulzim Basha, i cili përsëhndeti deklaratën e Mateo Salvinin për mafien, ka ardhur dhe reagoni i parë nga qeveria. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati u përgjigj Bashës me ironi se, "shpresoj që llogaria e Bashës të jetë hakuar". "Unë më të vërtetë shpresoj se kjo llogaria e udhëheqësit të opozitës shqiptare është sulmuar, përndryshe askush nuk mund të shpjegojë këto komente të Lulzim Bashës mbi popullin dhe vendin e tij", shprehet ministri Bushati.



Përmes një postimi në "Facebook" sot në mëngjes, Basha dha një mesazh ndërsa shtoi se me atë kurajë do të përballen edhe sot për fitore. "Bashkë me qindra të rinj kujtuam kurajën e mijëra të rinjve 28 vite më parë, kur gjithçka ishte në dorën e diktaturës. Të frymëzuar nga kuraja e tyre, do bëjmë sot atë që na takon: përballje, deri në fitoren e demokracisë, e shtetit të së drejtës!", shkruan Basha në 'FB'. Dy ditë më parë kreu i PD-së, Lulzim Basha para të rinjve akuzoi fort kryeministrin Edi Rama

si pengesa kryesore e moshapjes së negociatave me BE-në. Sipas tij, nuk hapen negociatat me një kryeministër të lidhur me drogën. Basha në një takim me një grup të rinjsh kujtoi 2 korrikun e 1990-ës, datën në të cilën 28 vite më parë, qytetarët e Tiranës hynë në ambasadën gjermane duke paralajmëruar fundit e regjimit diktatorial. Gjatë fjalës së tij, Basha falënderoi të gjithë ata të rinj që në atë kohë u futën në ambasadë dhe kanë 'digjen' që sipas tij, sollin edhe shembjen e murit të diktaturës.



Mediu në Londër, në forumin për Sfidat e Ballkanit Perëndimor

Në forumin për Sfidat e Ballkanit Perëndimor, ish-sekretari britanik i Mbrojtjes, lordi Des Braun dhe ish-ministri shqiptar i Mbrojtjes, Fatmir Mediu diskutuan çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me të ardhmen evropiane, rolin e NATO-s, ndikimin rus dhe atë turk, interesin e Kinës për të investuar në sektorët strategjikë të lidhur me sigurinë. Mediu vuri në dukje faktin se mungesa e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme është tregues i qartë i shmangies nga funksionimi demokratik i vendeve në rajon, ku korrupsioni dhe krimi i organizuar kanë fituar pushtet politik dhe vendimmarrës.



Takimi i djeshëm në Shkodër

MATTEO SALVINI

"Për mafiozët mbaroi koha, kur bënin si 't'u donte qejfi! Tani duhet të demonstrojmë se shteti është më i fortë. Në fund, do të më pëlqente të kujtohesha si ai që luftoi Camoran, Ndragheten dhe mafien më shumë se të tjerët", shprehet ministri i Brendshëm i Italisë dhe lideri i Lega-s.



"Shpërthimi" i ambasadave para 28 viteve

Paloka: Ramën e gënjen mendja, por do ta qërojmë si Ramiz Alinë

Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka, teksa kujton ngjarjet e ambasadave në 2 korrik të vitit 1990, shprehet se "shpërthimi i ambasadave ishte një nivel tjetër i revoltës së shqiptarëve, por atë moment Alia u përpoq ta përdorte në favor të tij. Paloka i kujton Edi Ramën se shqiptarët do të rezervojnë të njëjtin fat që kishte ish-udhëheqësi komunist, Ramiz Alia 28 vite më parë. "Ai lejoi largimin e njerëzve me ambasadat, i bindur se kështu largoi nga vendi të gjithë kundërshtarët dhe siguroi paprekshmërinë e regjimit. Kjo ishte një strategji e ndjekur dikur edhe nga Fidel Kastro. E të njëjtin strategji duket se po përdor sot Rama, i cili shpreson që të gjithë kundërshtarët e tij të largohen dhe ai të mbretërojë i vetëm në Shqipëri. Ramiz Alisë i dështoi plani, në dhjetor i qëruam. Ramën e gënjen mendja nëse mendon se do të ketë tjetër fund", shprehet z.Paloka.



"Ramiz Alisë i dështoi plani, në dhjetor i qëruam. Ramën e gënjen mendja nëse mendon se do të ketë tjetër fund", shprehet z.Paloka.



Mbledhja e dy qeverive Shqipëri-Mali i Zi, nënshkruhen 6 marrëveshje bashkëpunimi

Refugjatët, Rama-Markoviç: Nuk kemi pse jemi as vend gardhesh, as kampesh

Kryeministri malazez: Negociatat duhet të hapeshin këtë vit

Darina Tanushi

Qeveritë e Shqipërisë dhe Malit të Zi fir mosën dhe marrëveshje për një bashkëpunim më të thellë mes tyre, hapje të një pike të re kufitare, policimin ajror e emergjencat civile. Pas mbledhjes së përbashkët të dy kabineteve, organizuar në Shkodër, të dy kryeministrat, Edi Rama e Dushko Markoviç shprehën të njëjtin mendim sa u përket refugjatëve. "Së bashku me Malin e Zi, ne nuk ishim pjesë e korridorit kur filloi kriza e madhe e refugjatëve, por në çdo tryezë kemi pasur një qasje të qartë. Jemi të gatshëm të marrim përsipër barrën tonë të përgjigjesisë në një plan evropian. Aq sa na takon objektivisht. Kemi pasur 15-fishin e fluksit të një viti më parë. Por si numër relativ nuk është i tillë që ne të vëmë alarmin dhe të trokasim në dyert e Europës", - tha kryeministri Rama. Rama nënvizoi se Shqipëria nuk është vendi për gardhe dhe për sfaqje refuzuese ndaj atyre që janë në nevojë ekstreme dhe që ikin nga zona ku kërcënohen jetët e tyre. "Edhe ne kemi pasur oferta për të marrë gardhe dhuratë, por ne jemi popull emigrantësh. Jemi popull që ka një histori krenarë shpëtimi të hebrëjve, që ishin më të shumtë në numër në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore sesa para Luftës së Dytë Botërore. Sot në Shqipëri strehohen afro 3 mijë refugjatë iranianë. Dhe të mos harrojmë se në këtë vend të vogël janë strehuar mbi 500 mijë refugjatë lufte që lëvizën nga shtëpitë e tyre për shkak të spastrimit etnik të Sllobodan Milosheviçit", - tha kryeministri Rama. "Jemi në kontakt me miqtë tanë për të garantuar që të mos jemi të kërcënuar nga flukse që nuk i përballojmë dot", - theksoi Rama. Ndërsa kryeministri malazez, Dushko Markoviç u shpreh se, "përsa i përket emigracionit, asgjë e re nuk po ndodh në krahasim me 2015-ën. Fluksi i madh migrator nuk e ka kapur Malin e Zi. Në 2015-ën, Mali i Zi miratoi planin operacional ndaj migrantëve. Sot ka disa arsye politike manipuluese, që



Dy kryeministrat, Edi Rama e Dushko Markoviç gjatë konferencës për shtyp

NEGOCIATAT

"Ne tanimë kemi hyrë në një fazë të re, sa i takon rrugës sonë së integrimit në BE me marrjen e një date për çeljen e negociatave zyrtarisht, por më e rëndësishme akoma, për fillimin e procesit parapërgatitor për negociatat, i cili 'de facto' është një proces që nis me çeljen e negociatave", - tha Rama.



Shqipëri-Mali i Zi, Xhaçka: Bashkëpunim mes emergjencave civile dhe patrullimit ajror

Shqipëria dhe Mali i Zi nënshkruan sot marrëveshjen për Policimin Ajror dhe Emergjencat Civile, pas mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, të mbajtur në Shkodër. Pas nënshkrimit të marrëveshjes me homologun malazez, ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, Olta Xhaçka tha se, "si anëtarë të NATO-s kontribuojmë në mënyrën më të mirë në sigurinë dhe stabilitetin e rajonit. Shqipëria dhe Mali i Zi janë kontribuues faktikë në rritjen e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe NATO. Marrëveshjet përbëjnë një hap të rëndësishëm në rrugëtimin tonë rajonal dhe atë euro-atlantik". Xhaçka ka theksuar se Shqipëria dhe Mali i Zi do të kenë bashkëpunim të shkëlqyer mes emergjencave civile dhe patrullimit ajror. "Ne kemi vullnet të përbashkët për të bashkërenduar përpjekjet për rritjen e sigurisë së qytetarëve tanë. Ndajmë të njëjtat rreziqe dhe përballlemi me të njëjtat sfida me Malin e Zi. Jemi pranë njëri-tjetrit për t'ofruar ndihmë për të përballuar me sukses këto kërcënime të përbashkëta. Vendet tona kanë detyrime ndaj Aleancës. Këto marrëveshje materializojnë pikërisht përmeshjen e këtyre detyrimeve", - ka sqaruar Xhaçka. Ministria tha se me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, i hapim rrugën bashkëpunimit për rritjen e sigurisë në rajon dhe zonën Euro-Atlantike.

MARRËVESHJET E NËNSHKRUARA NË MBLEDHJEN E PËRBASHKËT TË QEVERIVE TË SHQIPËRISË DHE MALI I ZI:

1. Deklaratë e përbashkët ndërmjet Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Edi Rama dhe Kryeministrit të Malit Zi, Dushko Markovic, në kuadër të takimit të parë ndërqeveritar Shqipëri - Mali i Zi.
2. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi mbi marrëdhëniet e ndërsjella në fushën e menaxhimit të burimeve ujore ndërkuftitare.
3. Marrëveshje mbi bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në emergjencë nëpërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi.
4. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi në lidhje me operacionet ndërkuftitare të patrullimit ajror.
5. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët kufitare në Zogaj-Skje për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në Liqenin e Shkodrës.
6. Programi i bashkëpunimit në fushën e kulturës ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Malit të Zi për periudhën 2018-2020.



Pikë e re kufitare mes Shqipërisë e Malit të Zi në Zogaj, Shkodër

Në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive në Shkodër, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe homologu i Malit të Zi, z.Mevludin Nuhodzic, firmosën marrëveshjen për hapjen e një pike të re kufitare në Zogaj, Shkodër. Hapja e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Shqipëri) - Skje (Mali i Zi) do të jetë funksionale për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve. Pika kufitare është dakordësuar mbi mundësitë për fuqizimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit fitimprurës të dyanshëm dhe afatgjatë, duke krijuar kushte optimale për zhvillimin e këtij bashkëpunimi përmes lehtësimit të qarkullimit në kufirin e përbashkët shtetëror. Pika e Përbashkët e Kalimit Kufitar do të jetë me një ndalesë, duke thjeshtuar procedurat kufitare.

thonë që ne do të ndërtojmë kampe refugjatësh. Kjo nuk do të ndodhë. Vendi do të jetë i gatshëm për çdo sfidë konkrete". "Mali i Zi dhe Shqipëria kanë një qasje të përgjegjshme, nuk ka asnjë kërcënim, as nga ana shqiptare. Ne nuk parashikojmë as vënien e gardheve, as vënien e kampeve, ne jemi të sigurt, stabiliteti është prioritet i dy qeverive tona dhe mendoj se me përpjekjet e përbashkëta mund të sigurojmë zhvillimin e qëndrueshëm", - tha ai. "Bashkërisht do të punojmë që kufijtë tanë të jenë më të sigurt, që të dyja vendet tona të jenë më të sigurta, që nëse ndodh një fluksi i madh i emigrantëve tek të dyja vendet tona të sigurojmë obligimet tona, të ruajmë stabilitetin, sepse stabiliteti është diçka që nënkuptohet për qytetarët

tanë", - përfundoi kryeministri malazez. Markoviç uroi Shqipërinë për vendimin e BE-së për caktimin e një date për negociatat. "Përvoja jonë me negociatat është në dispozicion. Nuk jemi të kënaqur t'i hapë negociatat në 2019, donim të hapeshin këtë vit. Si politikan pragmatik shohim të ardhmen dhe do rikuperojmë. Mali i Zi dhe Shqipëria janë dy vende në zhvillim", tha Markoviç. Ndërkaq, kryeministri Rama foli për raportet mjaft të mira me Malin e Zi dhe projektet e reja që prekin të dyja vendet. "Do nisim përgatitjet për autostradën e kaltër, apo Adriatiko-Joniano, që përfshin Malin e Zi dhe Shqipërinë, për të avancuar procesin e lehtësimeve tregtare. Kompanitë që janë të interesuara të lehtësojnë procedurat e kalimit", tha Rama.

MARRËVESHJA DEKLARATA

Ministri grek i Mbrojtjes: Epiri i Veriut, zona ku grekët ekzistojnë dhe do të ekzistojnë

Kammenos: Çamët janë kriminelë lufte, bashkëpunuan me nazistët

"Çështja e pronave nuk kanë lidhje me çamët"

Valentina Madani

Ministri grek i Mbrojtjes, Panos Kammenos, akuzoi sërish dje komunitetin çam, duke i quajtur kriminelë dhe ish-bashkëpunëtorë të nazistëve. Kammenos foli për mediat greke një ditë pas publikimit të disa detajeve të marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Greqisë nga ana e tyre. Në deklaratën e tij, Kammenos vlerëson bashkëpunimin që ka pasur mes dy palëve për çështjen e varrezave të ushtarëve grekë, por ka mohuar që në marrëveshje të negociohet për çështjen çame, pasi sipas tij, ata janë kriminelë lufte dhe me të tillë nuk negociohet. Sipas tij, ato që thuhet për çështjen e pronave nuk kanë lidhje me çamët. Duke iu referuar marrëdhënieve me Shqipërinë, Kammenos njoftoi se është informuar nga kryeministri që po mbyllet çështja e Zonave Ekskluzive Ekonomike, ashtu si dhe me vende të tjera, por shtoi se komunikimet përkatëse do të bëhen nga ministri i Jashtëm. "Duke marrë shembullin e varrezave, mund të themi që Shqipëria po fillon të kuptojë se është në mirë të saj të ketë marrëdhënie të mira me Greqinë. Sa i përket Vorio Epirit, është një rajon i populluar nga grekët. Pakica do të mbrohet. Ndërsa çfarë pritet të diskutohet me pretendimet pronësore nuk kanë lidhje me çështjen çame. Çamët janë kriminelë lufte, që bashkëpunuan me nazistët dhe ne nuk do të negociojmë me kriminelë", tha ministri grek. Kammenos, kryetar i partisë së djathtë "Grekët e pavarur", foli edhe për zonën ku jeton minoriteti grek në Shqipëri, duke iu referuar asaj zone me termin "Epiri i Veriut". "Epiri i Veriut është zona ku grekët ekzistojnë dhe do të ekzistojnë. Minoriteti do të mbrohet", tha ministri grek i Mbrojtjes. Shqipëria dhe Greqia kanë pasur disa raunde bisedimesh për



Ministri grek i Mbrojtjes,
Panos Kammenos

DEKLARATA

"Shqipëria po fillon të kuptojë se është në mirë të saj të ketë marrëdhënie të mira me Greqinë. Sa i përket Vorio Epirit, është një rajon i populluar nga grekët. Pakica do të mbrohet. Ndërsa çfarë pritet të diskutohet me pretendimet pronësore nuk kanë lidhje me çështjen çame. Çamët janë kriminelë lufte, që bashkëpunuan me nazistët dhe ne nuk do të negociojmë me kriminelë", - tha ministri grek.

Ministri deklaroi se çamët janë kriminelë lufte

Doda: Kammenos si derr i majmur, pasardhës i kriminelit Zerva

Partia për Drejtësi, Integritim dhe Unitet reagoi dje pas deklaratave të ministrit grek të Mbrojtjes, Panos Kammenos, duke theksuar se ai është pasardhës i kriminelit Napoleon. Sekretarja e përgjithshme e PDIU-së, Mesila Doda, tha se Kammenos u shfaq tejet i kënaqur me marrëveshjen midis Shqipërisë e Greqisë. "Ministri i Mbrojtjes grek, Panos Kammenos, u shfaq sot në mediat greke tejet i kënaqur për marrëveshjen midis Shqipërisë e Greqisë. Pasi hoqi uniformën ushtarake, që sfidoi për turpin e vet në kufirin tonë jugor dy vite më parë, del si



derr i majmur e i kënaqur e deklaroi se morëm nga marrëveshja me Shqipërinë atë që deshëm dhe se 'çamët janë kriminelë lufte që bashkëpunuan me nazistët dhe se ne nuk do të negociojmë me kriminelë', theksoi zj.Mesila Doda. Në të vërtetë

Kammenos sipas Dodës është i fundit politikan që mund të flasë për kolaboracionistë e kriminelë, sepse është përfaqësuesi tipik ultranacionalist, pasardhës i atit të tij shpirtëror, kriminelit Napoleon Zerva. "Nuk di çfarë ka ndryshuar qysh herën e fundit që tregonte tanket e ushtrinë në kufirin tonë, akt i paimagjinueshëm mes dy vendeve anëtare të NATO-s, por më duhet t'i rikujtoj disa foto të paraardhësve të kolegëve të tij në kabinetin qeveritar e të ish-kryeministrit të tij me nazistët e kriminelët. Nga këtu le të gjejmë cilët janë kriminelët e cilët viktimat...", shprehet zj.Doda.

moset nga dy kryeministrit.

MARRËVESHJA
Ministri grek i Mbrojtjes dhe aleati kryesor në qeveri i kryeministrit Tsipras, Panos Kammenos kërcënoi me zgjedhje të parakohshme në lidhje me marrëveshjen për emrin e Maqedonisë. Në një

konferencë të jashtëzakonshme për shtyp nga zyrat e partisë së tij, Kammenos u shpreh se nuk duhet të përjashtohet populli grek nga kjo vendimmarrje. "Dhe për këtë ka dy mënyra - deklaroi Kammenos. - Ato janë me zgjedhje ose me referendum".



ÇAMËRIA'

Kotzias: Është qesharake të mendosh se Epiri i Veriut i përket Greqisë

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, reagoi pas shkrimit në mediat greke se në bisedimet Bushati-Kotzias ishte rënë dakord për një shkëmbim terrash Çamëri dhe Epiri i Veriut. Sipas Kotzias, "është qesharake që ndokush të mendojë që Epiri i Veriut i përket Greqisë". I pyetur gjatë një interviste nëse pala greke ka përfshirë në negociatë edhe këtë çështje, Kotzias është përgjigjur: "Nuk është shtruar gjë për termin 'Epirin e Veriut', ashtu sikurse është qesharake disa të konsiderojnë se 'Epiri i Veriut' i përket Greqisë. Duhet të merremi vesh. A i njohim kufijtë ashtu siç u përcaktuan mbi bazën e Aktit Final të Helsinkit në 1975? A pranojmë aktin final të Parisit të 1926-s? A i njohim rezultatet e dy luftërave botërore? Sepse disa të Demokracia e Re thonë gjenjshtra të paskrupullta, gjoja se ne po shkëmbejmë Çamërinë me Epirin e Veriut e të tjera si këto. Duket se harrojnë që ajo që quhet Epiri i Veriut i përket sot një shteti të pavarur e sovran. Po që kështu, le të na e thonë direkt. Duan ndryshim të kufijve"? Ai foli për marrëveshjen e detit të vitit 2009, duke thënë se ajo ishte një marrëveshje që "u bë për të mos u konkretizuar". Kotzias, ashtu siç ka bërë disa herë ditët e fundit, ka deklaruar se "as kam pranuar dhe as kam për të pranuar që të diskutohet çështja çame" dhe se pronat e shtetasve shqiptarë të kaluar në sekuestro me shpalljen e ligjit të luftës janë krejt tjetër çështje nga pronat e çamëve". Sipas tij, pronat e sekuestros nuk janë më shumë se 200.



PRONAT
Kotzias tha se, "as kam pranuar dhe as kam për të pranuar që të diskutohet çështja çame" dhe se pronat e shtetasve shqiptarë të kaluar në sekuestro me shpalljen e ligjit të luftës janë krejt tjetër çështje nga pronat e çamëve". Sipas tij, pronat e sekuestros nuk janë më shumë se 200.

Kammenos shprehet se marrëveshja me Maqedoninë për emrin nuk ka asnjë vlerë nëse nuk ratifikohet nga parlamenti grek. Në këtë pikë, ministri grek i Mbrojtjes theksoi se kjo marrëveshje duhet votuar nga të gjithë 140 deputetët.

Në të kundërt, do të duhet të pyetet populli, duke shkuar në zgjedhje të parakohshme ose nëpërmjet referendumit. Panos Kammenos sjell në vëmendje edhe mosdekretimin e marrëveshjes nga Presidenti i Maqedonisë, i cili refuzoi ta firmoste.



Gjiqtarët dhe prokurorët që nuk e kaluan dot vetingun kanë mundësi që të rikthehen në fushën e drejtësisë, por vetëm si avokatë. Deputetët socialistë votuan dje të vetëm pa konsensusin e opozitës, ndryshimet në ligjin për avokatinë, ndonëse në 2 maj gjatë prezantimit të draftit, kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja ishte shprehur kundër. Gjatë mbledhjes, kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja u shpreh: "Ky është profesion i lirë, punojnë mbi 10 mijë veta". Drafti ka marrë kundërshtitë edhe nga deputetë të mazhorancës. "Pse të bëhet avokatia, streha e gjyqtarëve të korruptuar", u shpreh deputeti Bashkim Fino. Ndërsa avokati i njohur Maks Haxhia u shpreh: "Profesion i lirë, nëse është i paafatë, do jetë edhe si avokat i tillë. Ne nuk mund të bëjmë dot gjykatën, nëse e dënon gjykata, po". Shumica kaloi në Komisionin e Ligjeve edhe ndryshimet në draftin për Shkollën e Magjistraturës, por për miratimin e tij në Kuvend nevojitet edhe konsensusi me opozitën, pasi ky ligj kërkon 84 vota. Deputetët e LSI-së refuzuan vendimin e mazhorancës, duke mos i dhënë konsensusin për miratimin e ligjit për "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në Komisionin e Ligjeve. Partia Socialiste priti disa javë për të arritur këtë konsensus, ndërsa LSI tha se nuk mund të japë votat për t'i rikthyer Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë të drejtën e emërimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në mungesë të 84 votave, ndryshimet në këtë ligj të propozuara nga Ulsi Manja dhe Klotilda Ferhati mbahen pezull. Propozohen ndryshime në dy nene, duke i kthyer Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit

Deputeti i PS, Fino: Avokatia të mos behët streha e gjyqtarëve të korruptuar

Gjiqtarë e prokurorë të rrëzuar nga vetingu rikthehen si avokatë, LSI kundër PS

Naço: Mazhoranca kërkon të shtyjë afatin e Arta Markut

të Lartë të Drejtësisë të drejtën e emërimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, deri në ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Po ashtu, socialistët propozojnë në ligj dhe hapjen e

konkursit nga shkolla e magistraturës për magistratë të rinj. Deputeti i LSI-së, Nasip Naço tha dje: "Nuk kërkon as më shumë as më pak, por të shtojë pambarimisht afatin e Prokurorisë së Përgjithshme të Përkohshme në detyrë, pa asnjë lloj limiti dhe të bëjë ajo emërimet e këtyre magistratëve që kanë mbaruar për vitin 2017-2018. Dhe nuk mund të kthehemi përsëri 180 gradë dhe këtyre studentëve të magistraturës që kanë mbaruar t'u themi një pjesë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që bëni ju emërimet dhe po e lini të hapur dhe KLGJ edhe KLP në kalenat greke prandaj kam votuar kundër. Ju uroj mbarësi në reformën në drejtësi".



ADNOR SHAMETI
Deputeti socialist, me profesion avokat tha dje në një intervistë televizive se, "gjyqtarët dhe prokurorët mund të dështojnë në veting, por nuk mund të shkelin Kushtetutën duke i përjashtuar, i kemi tejkaluar sentimentalizmat. Varet nga klientët nëse duan një avokat të pastër apo jo, pasi është profesion i vetëregulluar".



Ruçi-Sharaf: Mbështetje, investimeve saudite në Shqipëri

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, gjatë një takimi dje, me ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, Abdelmomen Mohammed Sharaf theksoi nevojën e përfundimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve midis të dy qeverive që janë në proces, si ato në fushën fiskale, të turizmit, transportit ajror, në fushën ushtarake etj. Gjatë takimit, Ruçi i shprehu ambasadorit Sharaf urimet për vijimin me sukses të misionit të tij diplomatik në Shqipëri, ndërsa vlerësoi se marrëdhëniet shumë të mira midis të dy vendeve mund dhe duhet të intensifikohen. Kryetari i Kuvendit theksoi edhe nevojën e rritjes së bashkëpunimit parlamentar midis të dy vendeve. "Diplomacia parlamentare e Shqipërisë po merr një rëndësi gjithnjë e më të madhe, si një mjet efikas për rritjen e kontakteve dhe forcimin e marrëdhënieve dy e shumëpalëshe", - theksoi Ruçi.

Virgjl Kule: Bashkëpunimi me Suedinë, në favor të pranimit të Shqipërisë në BE

Komisioni për Politikën e Jashtme zhvilloi një seancë dëgjimore me katër kandidatët për ambasadorë. Të futur në mbledhjen e Komisionit ishin z. Ilirjan Kuka, kandidat për ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqplotë i RSH-së në Republikën e Çekisë, z. Rezar Bregu, kandidat për ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqplotë i RSH-së në Republikën Federative të Brazilit, Z.Riza Poda, kandidat për ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqplotë i RSH-së në Republikën e Kroacisë, rezident si dhe ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqplotë i RSH-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, jorezident dhe z. Virgjl Kule, në postin e kreu të Misionit Diplomatik, ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqplotë i RSH-së në Mbretërinë e Suedisë, rezident si dhe në Republikën e Finlandës, Republikën e Islandës dhe Mbretërinë e Norvegjisë, jorezident. Virgjl Kule në prezantimin e tij theksoi se në programin e tij të punës do të jetë bashkëpunimi i ngushtë institucional me Suedinë për çështjet sociale, ekonomike dhe politike, në favor të pranimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Kandidati i dytë, Riza Poda vuri theksin në rolin e Kroacisë si aleat me rëndësi për Shqipërinë në rajon dhe në bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e turizmit, në fushën e investimeve, legjislacionit dhe integritimit evropian. Kandidati Rezar Bregu, për ambasador në Brazil tha se do të punohet për realizimin e vizitave të nivelit të lartë të autoriteteve braziliane, gjë që nuk ka ndodhur deri tani. Ilirjan Kuka, kandidat për ambasador në Çeki u shpreh për forcimin e marrëdhënieve mes dy shteteve.

United Nations Development Programme

VACANCY ANNOUNCEMENT

The United Nations Development Programme in Albania is looking for qualified candidates who could fill the following vacancies:

Posts Titles: 1- National Consultant – Trainer/Mentor, Self-employment
2- National Consultant – Team Leader/Trainer, Self-employment
3- National Consultant – Curricula Developer/Trainer, Self-employment

Type of Contract: Individual Contract

Project: Skills Development for Employment Programme
Duty Station: Tirana, Albania

Deadline for Application: July 6, 2018
Job Description: <http://al.undp.org>

Qualified and interested candidates are requested to apply online via UNDP Albania website: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>. Interested applicants are advised to carefully study all sections of this ToRs and ensure that they meet the general requirements as well as specific qualifications described. Incomplete applications will not be considered. Please make sure you have provided all requested materials. Qualified women and members of social minorities are encouraged to apply.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – RFP for INCREASING LOCAL GOVERNMENT PUBLIC ETHICS AND INTEGRITY

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 47717**
RFP for INCREASING LOCAL GOVERNMENT PUBLIC ETHICS AND INTEGRITY

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **23 July 2018**

Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org
Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

Komisioni i kërkon shpjegim për komandimet, shqyrtohen ankesat ndaj saj. Sot jepet vendimi

Vetingu, Arta Marku drejt konfirmimit, KPK: Nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë

"Deklarim i saktë në ILDKPKI dhe nuk ka konflikt interesi"

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar ditën e djeshme seancën dëgjimore me kryeprokuroren e përkohshme, Arta Marku. Prokurorja e Përgjithshme nuk ishte e pranishme në seancë, duke u përfaqësuar nga avokatja Lirime Çukaj. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, organi bazë i vetingut, njohu Markun me rezultatet e hetimit të thelluar për ligshmërinë e pasurisë, kontaktet e mundshme me botën e kimit dhe aftësitë profesionale të saj. Ndërkohë vendimi për Arta Markun do jepet ditën e sotme. Trupa gjyqësore për vlerësimin e kryeprokurores, përbëhet nga Genta Tafa, Pamela Qirko dhe Suela Zhegu.

SEANCA DËGJIMORE

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit u shpreh se nga verifikimi i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe i vetë komisionit ka rezultuar se gjyqtarja nuk ka shkelje dhe fshehje të pasurisë, ka bërë deklaram të saktë, ka burime të mjaftueshme financiare dhe nuk ka konflikt interesi. Ndërsa DSIK konfirmon përshtatshmërinë e Markut në detyrë. "ILDKPKI na ka sjellë raportin për Arta Markun se ka bërë deklaram të saktë, burime të ligjshme, nuk ka fshehur pasurinë dhe se nuk ka bërë deklaram të rremë. Komisioni ka bërë hetim të thelluar për pasurinë, burimet e krijimit, të ardhurat dhe fshehjet e pasurisë. Hetimi nga KPK është bërë për pasuritë, një apartament banimi 103m2 me vlerë 5 mln lekë me adresë në Perash, Shkodër. Apartamenti është blerë me kredi. Apartament banimi me sipërfaqe 60 m2 me adresë lagja "Vasil Shanto", Shkodër dhe një shtëpi sipër tij, ku bashkëshorti zotëronte 25 për qind, të krijuara me të ardhura të ligjshme. DSIK ka sjellë raport për Arta Markun ku thotë se është e përshtatshme, nuk ka asnjë problem", u shpreh relatorja e trupës së KPK-së Suela Zhegu. Për aftësinë profesionale, KPK ka shqyrtuar një ankesë ndaj Markut, ku rezultoi se për një person të akuzuar për "drejtim mjetei në gjendje të parregullit", ka kërkuar masë të ashpër "arrest me burg". Mësohet se shtetasi A.P pretendon se Arta Marku i ka shkelur të drejtat, pasi nuk ka arsyetuar perse e ka kërkuar ta lërë në burg. Vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Theo Jacobs, fillimisht ka shprehur keqardhje për mungesën e Markut në seancë. Ai tha se do të donte të kishte debat me Arta Markun lidhur me çështje të ajo ka marrë pjesë, ku ka kërkuar "arrest me burg" për shtetasin e ndaluar për "drejtim mjetei në gjendje të parregullit". "E shoh si një shenjë jo të mirë mungesën e saj. Arta Marku duhej të ishte këtu. Në lidhje



Kryeprokuroreja Arta Marku

PASURIA

"ILDKPKI na ka sjellë raportin për Arta Markun se ka bërë deklaram të saktë, burime të ligjshme, nuk ka fshehur pasurinë dhe se nuk ka bërë deklaram të rremë. Hetimi nga KPK është bërë për pasuritë, një apartament banimi 103m2 me vlerë 5 mln lekë me adresë në Perash, Shkodër. Si dhe apartament banimi me sipërfaqe 60 m2 me adresë lagja "Vasil Shanto", Shkodër.

AVOKATJA

Në përfundim të seancës dëgjimore Lirime Çukaj, avokatja mbrojtëse e Arta Markut përpara KPK-së ka kërkuar rikonfirmimin e kryeprokurores në detyrë. "S'kemi asnjë pretendim. Jemi të hapur për pyetje. Arta Marku të rikonfirmohet në detyrë", u shpreh avokatja Çukaj.

Probleme me pasurinë, nga lotaria tek kreditë

Në "sitën" e vetingut, prokurori i Apelit Luan Kaloçi, KPK: Ka deklaram të rreme

Prokurori i Apelit të Tiranës Luan Kaloçi u përball ditën e djeshme në seancë dëgjimore me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Trupa gjyqësore e përbërë nga Xhensila Pine, Valbona Sanxhaktari si dhe Etleda Çiftja, ka lexuar raportin për Kaloçin, i cili është një nga kandidatët për në KLP. KPK bazuar tek deklaramta e ILDKPKI-së, pohon se Kaloçi ka mungesë burime financiare ka deklarim të rreme dhe ka fshehje pasurie. Ndërkohë, KPK kreu hetim vetëm për kriterin e pasurisë. Sakaq, KPK tha se nga hetimi rezultoi se apartamenti 145 m2, vlera e deklaruar është 52 mijë dollarë. Nga analiza e bërë në deklarimet në vite dhe dokumentacioni i siguru-



Prokurori i Apelit, Luan Kaloçi

ar nga KPK kishte mospërpunje. Prokurori si fillim është shprehur se për blerje përdori paratë që përfitoi nga shitja e shtëpisë në Elbasan, ndërsa në deklarimet veting

thuhet se e bleu me kredi. Ndërkohë, ka edhe mospërpunje të për sipërfaqen si dhe për burimin e të ardhurave me të cilat ka blerë dyqanin. Vetë prokurori kishte dek-



PASURIA

Trupa gjyqësore e përbërë nga Xhensila Pine, Valbona Sanxhaktari si dhe Etleda Çiftja ka lexuar raportin për Kaloçin, i cili është një nga kandidatët për në KLP. KPK bazuar tek deklaramta e ILDKPKI-së, pohon se Kaloçi ka mungesë burime financiare ka deklarim të rremë dhe ka fshehje pasurie.

Marku nuk ka paraqitur dokumente. Prokurorja e Përgjithshme ka informuar se urdhri për komandimet është i bazuar në ligj. Arta Marku s'ka ndërmarrë asnjë hap për të përmirësuar procedurën e emërimeve", thuhet nga KPK. Sakaq, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka shqyrtuar dy denoncime nga shtetasit me iniciale TN dhe N.O, por që kanë rezultuar pa probleme.

Në përfundim të seancës dëgjimore Lirime Çukaj, avokatja mbrojtëse e Arta Markut përpara KPK-së, ka kërkuar rikonfirmimin e kryeprokurores në detyrë. "S'kemi asnjë pretendim. Jemi të hapur për pyetje. Arta Marku të rikonfirmohet në detyrë", u shpreh avokatja Çukaj.

KARRIERA

Ish-prokurorja e Shkodrës Arta Marku u zgjodh kryeprokurore e përkohshme në Kuvend, në një seancë të pazakontë më 18 dhjetor të 2017, kur deputetët e opozitës hodhën tymosë në shenjë proteste ndaj mënyrës së zgjedhjes së saj. 42-vjeçarja që punonte deri në atë kohë si zvdrejtuese e Prokurorisë së Shkodrës u ngjit në postin më të lartë të akuzës vetëm me votat e mazhorancës, pas 17 vitesh karrierë në sistemin e drejtësisë. Ajo është pjesë e listës prioritare të vetingut për shkak të pozicionit të saj në krye të prokurorisë, por edhe se më parë kishte kandiduar për një post në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Arta Marku e ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2002, kohë kur ka punuar për 1 vit si prokuror në Prokurorinë e Fierit. Më pas ajo është transferuar në Shkodër, ku ka ushtruar detyrat si prokuror, drejtuese e Task-Forcës për hetimin e kimit ekonomik dhe korrupsionit si dhe zv. Drejtuese e Prokurorisë.

Alibeaj



VETINGU

Deputeti i PD, Enkelejd Alibeaj, ka akuzuar vetingun se po përdor standarde të dyfishta për rivlerësimin e gjyqtarëve. Sipas tij, Marku duhet të ishte shkarkuar sepse ka shkelur ligjin duke bërë emërimet dhe shkarkime pa pasur tagrin për ta bërë një gjë të tillë. "Organet e vetingut po zbatojnë standarde të dyfishta duke vënë në dyshim serioz besueshmërinë ndaj procesit. Rasti i Arta Markut është prova e qartë për këtë", tha Alibeaj.

me rastin e shtetasit që është arrestuar për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, sepse kishte pirë pak më shumë raki, Arta Marku kërkoi dy herë arrest me burg për të. Nuk e mbështes

idenë që duhet të drejtohen nën efektin e alkoolit, por dua të përqendrohem te kërkesa ekstreme për arrest me burg. Së pari, subjekti ka një përvojë të lartë si prokuror, nuk është fille-

stare. Ajo e di dallimin mes një çështjeje të vështirë dhe të thjeshtë. Shoh jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në Shqipëri. Në 2011, Kolegjet e Bashkuara kanë thënë se kërkesa e paraqitur nga prokurori për caktim masash sigurie duhet të jetë e argumentuar në lidhje me rrezikshmërinë e veprës. Ndryshe nga vendet e Europës, nëse do marr shifrat e Shqipërisë, shoh se 44 për qind e njerëzve janë në paraburgim. Ka një problem këtu për prokurorinë, sepse ata japin sinjalin, ata kanë përgjegjësi për këtë gjë", u shpreh përfaqësuesi i ONM Theo Jacobs. Për sa i përket mungesës së Markut në seancë, avokatja Lirime Çukaj u shpreh se klientja e saj e pa të arsyeshme të mos ishte e pranishme. Ndërsa në

lidhje me masën e sigurisë "arrest me burg" për shtetasin e mësipërm, avokatja u shpreh se "prokuroria është subjekti që kërkon, por vendimin e merr gjykata". Më tej kryesuesja e seancës, Genta Tafa Bungo, e cila kërkoi nga avokatja e kryeprokurores sqarime për mos paraqitjen në këtë seancë të Arta Markut, u ndal në riorganizimin dhe lëvizjet e komanduar të ndërmarrja nga Marku pas zgjedhjes në dhjetor 2017 në krye të organit të akuzës. Kujtojmë se Arta Marku pasi mori detyrën e Prokurorisë së Përgjithshme, ndërmoi masa për disa komandime, dhe duke pezulluar disa të tjera. Gjatë seancës në KPK, u bënë pyetje specifike për këtë mënyrë riorganizimi. "Megjithatë i janë kërkuar shpjegime për komandimet,

Në Tiranë vjen zëvendësndihmës Sekretarja në Byronë e Europës në DASH

Kush e pason Lu? Trump emëron ambasadorën e re në Shqipëri

Kathleen Ann Kavalec, eksperiencë 30-vjeçare

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump ka nominuar emrin e Kathleen Ann Kavalec, si ambasadore fuqplotë në Shqipëri. Kjo e fundit, nëse merr miratimin nga Senati, pritet të zëvendësojë ambasadorin aktual Donald Lu, të cilit i përfundoi mandati dhe do të largohet nga Tirana. Kathleen Ann Kavalec aktualisht shërben si zëvendësndihmës Sekretare në Byronë e Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike në Departamentin Amerikan të Shtetit dhe ka mbi tri dekada përvojë si diplomate amerikane. Më parë ka shërbyer si drejtoreshë e Zyrës së Punëve Ruse, zëvendëssehefe e Misionit të SHBA-ve në UNESCO në Paris, zëvendëskoordinatore për Ndihmë në Byronë Evropiane dhe drejtore për Parandalimin e Konfliktit në Zyrën e Koordinatorit për Rindërtim dhe Stabilizim. Kavalec flet rrjedhshëm gjuhët frënge, rumune, ukrainase, ruse, spanjolle dhe portugeze, ndërsa ende nuk dihet nëse do të arrijë të flasë shqip me Tiranën. Një nga punët kryesore të ambasadores së re pritet të jetë asisten-



Ambasadorja e emëruar në Shqipëri, Kathleen Ann Kavalec

ca diplomatike dhe teknike për reformën në drejtësi dhe ndihma për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Pak javë më parë, Ambasada e Shteteve të Bashkuara mirëpriti përparimin e



Ambasada Amerikane në Tiranë

bërë nga Shqipëria në luftën e saj kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Vendimi i gjykatës për të vendosur Saimir Tahiri në arrest shtëpie është një shenjë se kjo çështje e rëndësishme korrupsioni do të vendoset në mënyrë të drejtë dhe transparente në gjykata. Arrestimi i Met Kananit në Turqi dhe 14 anëtarëve të bandës së tij kriminale në Shqipëri është shenjë e seriozitetit të policisë dhe prokurorëve për të vënë në shënjestër krimin e organizuar. Së fundi, arrestimi i trafikantit të dyshuar të kokainës, Arber Çekaj në Gjermani dhe kërkesa për ekstradimin e tij në Shqipëri është shenjë se pandëshkueshmëria

KUSH ESHTË

Kavalec flet rrjedhshëm gjuhët frënge, rumune, ukrainase, ruse, spanjolle dhe portugeze, ndërsa ende nuk dihet nëse do të arrijë të flasë shqip me Tiranën.

ka marrë fund për bosët e krimit në këtë vend. Përgëzojmë punën e vështirë dhe me kurajë të Policisë së Shtetit, prokurorëve të Krimeve të Rënda dhe gjyqtarëve të Krimeve të Rënda", thuhet në deklaratën e ambasadës në muajin maj.

Mashtrimi me vizat, arrestohet 30-vjeçarja e dënuar me 4 vite burg

Policia e Tiranës ka vënë në pranga ditën e djeshme 30-vjeçarën Adele Makashi, e cila ishte shpallur në kërkim për veprën penale "Mashtrim". Gjykata e Tiranës më herët shpalli vendimin për shtetaset Luli dhe Adele Makashi, nënë e bijë, të cilat akuzohen se kanë mashtruar qytetarët me vizat e punësimit në Kanada. Gjykata ka dënuar me 9 vjet burg Luli Makashin, që nga gjykimi i shkurtuar shkon në 6 vjet. Ndërsa janë dhënë 6 vjet burg për të bijën, Adele, e cila me gjykim të shkurtuar do të vuajë 4 vjet. Mësohet se 360 shqiptarë kanë paguar diku të 20 mijë dollarë për viza pune në shtetin kanadez, pa marrë asgjë në këmbim, të mashtruar nga dy të akuzuara. Pas denoncimit të bërë nga 26 persona në qytet të ndryshme të vendit, Seksioni për Krimin Ekonomik-Financiar në Policinë e Tiranës zbardhi një skemë mashtrimi. Policia shqiptare njoftoi autoritetet kanadeze për shpalljen në kërkim të Luli Makashit dhe vajzës së saj, pas arrestimit të bashkëpunëtorit të tyre, Klevis Rreshka. Më tej autoritetet kanadeze bënë anulimin e vizave për këto dy shtetase për t'i rikthyer në Shqipëri. Dy të pandehurit dhe bashkëpunëtorit të tyre, Klevis Rreshka, u kanë premtuar personave të ndryshëm se do t'u sigurojnë dokumente punësimi dhe studimi për në Kanada, Australi, Angli e në disa vende të ndryshme jashtë shtetit, kundrejt shumave të konsiderueshme parash, të cilat varionin nga 2500 euro deri në 20 mijë euro.



WORLD BANK OFFICE, Tirana

VACANCY ANNOUNCEMENT

The World Bank Office in Tirana is seeking to employ a local Short-Term Temporary (STT) experienced Program Assistant. The incumbent is expected to perform in a demanding institution, with high professional standards. The World Bank is an important development partner of Albania, finances an extensive assistance program, and carries an active policy dialogue with the Government and other development partners.

Skills Required:

- A university degree or equivalent education.
- Demonstrated verbal and written communication skills, including the ability to communicate in Albanian. Excellent knowledge of written and spoken English is essential. Translation and interpretation skills would be a definite asset.
- Preference would be given to candidates with demonstrated experience as program assistants with a minimum of 2 years.
- Strong computer skills; proven ability to use standard and customized technology packages, e.g., Internet, Word, PowerPoint, Excel. Familiarity with Outlook Mail is preferable.
- Knowledge and understanding of information management, procedures and best practices, including the relevant technology and system knowledge.
- Familiarity with communications approaches, tools, and methodologies.
- Strong organizational, research/analytical and presentation skills.
- Knowledge of social, political and development issues in Albania to work closely with Sr. Communications Officer to make the service available on-line through the World Bank Country Office Website and Facebook.
- Teamwork/Collaboration skills and recognized ability to work effectively in a team-oriented environment.
- Outstanding verbal communication and interpersonal skills to interact effectively with a range of contacts internally and externally using maturity, good judgment, tact and diplomacy.
- Demonstrated skills in organizing, prioritizing, scheduling, planning and coordinating work and other activities internally and externally.
- Ability to take personal ownership and accountability to meet deadlines.

Terms and Conditions of Employment:

The position will be a short-term contract (up to 12 months). This position could be later converted into a longer-term contract provided the incumbent demonstrates satisfactory performance, and if an opening becomes available. Fees and benefits are highly competitive. The World Bank offers its permanent staff extensive opportunities for training and career development.

Applications shall include:

- A cover letter in English, documenting the applicant's skills and qualifications for this position.
- A copy of the University Diploma or other equivalent studies.
- A detailed Curriculum Vitae with the names and addresses of previous employers and a description of duties and responsibilities.
- The name, address and contact telephone number of at least two professional references from previous employers or teachers/professors (for recently graduated candidates).

All applications, including supporting documents, should be authentic and submitted to World Bank Office in a sealed envelope addressed to the Country Manager, no later than close of business July 6, 2018. Please note only short-listed candidates will receive responses within fourteen days of the job posting closing date.

Address
World Bank Office
"Ibrahim Rugova" Street, No. 34
Tirana, Albania
Tel: +355 (0) 42 280 650/51

unicef | for every child

UNITED NATIONS CHILDREN'S FUND (UNICEF)
Albania Country office

REQUEST FOR PROPOSAL FOR SERVICES

Subject: Develop and implement a model for the digitalization of birth - related records and their online transfer from maternities to Primary Health Care facilities.

The United Nations Children's Fund (UNICEF) is seeking to receive proposals from interested organizations/companies who wish to be considered for the provision of the above-mentioned services/works.

Please consult UNICEF Albania website (www.unicef.org/albania) or UN Albania website (<http://www.un.org.al/employment-and-procurement>) to download the detailed RFPS document and other related requirements.

The proposals will be evaluated and selected in accordance with established UNICEF procedures.

The offers must be delivered within the set deadline, in a sealed envelope which must be clearly marked: "LRPS-2018-9140968 - Develop and implement a model for the digitalization of birth - related records and their online transfer from maternities to Primary Health Care facilities." to the address below:

United Nations Children's Fund (UNICEF)

Rr. "Skënderbeu", ndërtesa e Agjencive të OKB-së, kati i tretë, Tiranë, Albania
Tel. +355 44548400; Website: www.unicef.org/albania

Relevant Dates: All interested companies must submit their application, not later than **16 July 2018, 12:00 hrs.**

Personat që janë shkëputur për afat të shkurtër nga puna, ja sa janë detyrimet për ISSH

Ornela Manjani

Tatimet: Formula e llogaritjes së kontributit shoqëror e shëndetësor

Llogariten edhe pagesat nga të vetëpunësuarit

Drejtorja e Tatimeve nxjerr "manualin" për pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore për personat që shkëputen përkohësisht nga puna. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka publikuar në faqen e saj zyrtare rastet e tjera të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Për punëmarrësit, që gjatë periudhës tatimore, për një pjesë, apo për gjithë periudhën, nuk kanë punuar për arsye se u ka lindur e drejta për të marrë përfitime afatshkurta nga skema e sigurimeve shoqërore, përfitimet do të kërkojnë në organet e sigurimeve shoqërore nëpërmjet tatimpaguesit përkatës sipas rregullave të përcaktuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Përfitimet nga skema e sigurimit shëndetësor, kontribuesi, i kërkon sipas rregullave të përcaktuara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Në të dhënat e deklarimit "Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi" tatimpaguesi nuk deklaron përfitimet e punonjësit të ndryshëm nga skema e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

PAGESA E RAPORTIT

Në mbështetje të Kodit të Punës dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për rastet e sëmundjeve dhe të kujdesit të fëmijës në ngarkim të raportit mjekësor, deri në 14 ditët e para të raportit paguhen nga punëdhënësi ndërsa pas ditës së 14 raportet mjekësore paguhen nga fondet e sigurimeve shoqërore. Të ardhurat e personit si pasojë e raportit mjekësor deri në 14 ditët e para, për efekt të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi trajtohen, njëjloj si edhe të ardhurat nga paga, pavarë-



Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve

sisht nga mënyra e llogaritjes së shpërblymit ditor. Pra, nga shuma e përllogaritjes së ardhurave të punëmarrësit ndalet kontributi i sigurimeve shoqërore, shëndetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi sipas përcaktimeve ligjore. Gjithashtu, punëdhënësi paguan kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që është detyrimi i tij dhe që llogariten kundrejt të ardhurave të punëmarrësit. Në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore ndahen, në përqindje mbi pagën bruto mujore, sipas degëve të sigurimit

shoqërore mund të llogarisë e paguajë mbi bazën e një page edhe më të madhe nga paga minimale në shkallë vendi deri në kufirin e pagës maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit.

PAGESAT

Personi fizik, për vete, me dëshirën e tij, kontributet e sigurimeve shoqërore mund të llogarisë e paguajë mbi bazën e një page edhe më të madhe nga paga minimale në shkallë vendi deri në kufirin e pagës maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të punëmarrësit.

shoqërore të punëmarrësit. Për personin fizik, i vetëpunësuar, me ose pa punëmarrës, si dhe për punonjësit e paguarar të familjes me të cilët ai punon e bashkëjetojnë ligjërisht, kontributi i sigurimit shoqëror llogaritet mbi pagën minimale në shkallë vendi, ndërsa kontributi i sigurimit shëndetësor llogaritet mbi dyfishin e pagës minimale në shkallë vendi mbi të cilën edhe llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore.

LLOGARITJA E KONTRIBUTEVE

Kontributet e sigurimeve shoqërore për të punësuarin llogariten mbi pagën bruto mujore brenda kufirit të pagës minimale në shkallë vendi dhe kufirit të pagës maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të miratuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave. Kontributi i sigurimit shëndetësor për të punë-

IPARD II, Peleshi nënshkruan marrëveshje për të lehtësuar kredimarrjen për fermerët

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Niko Peleshi nënshkroi në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, "Marrëveshjen e Bashkëpunimit" për të lehtësuar kredimarrjen e gjithë aplikuesve, që do të dalin fitues nga programi IPARD II, i cili pritet të çelë "Thirrjen e parë" në fillim të vjeshtës dhe që do të nënshkruajnë kontratë me AZHBR-në. Për ministrin Peleshi, programi IPARD II, është sfida më e madhe që i parashtrohet bujqësisë shqiptare, dhe vështrësia qëndron në përthithjen e fondeve të këtij programi, gjë që kërkon kapacitete njerëzore dhe mjete financiare. "Ajo që ne po bëjmë sot, në fakt, është një lajm shumë i mirë për të gjithë të interesuarit potencialë të skemës së IPARD-it, sepse me 5 institucione financiare të kreditimit dhe me tri banka pjesë e programit tonë të "Fondit të Garancisë", po firmosim një marrëveshje, sipas së cilës të gjithë fituesit e IPARD-it, do të kenë mundësi të aksesojnë burimet e financimit me kredi, pranë këtyre institucioneve në një kohë më të shpejtë, me kushte gjithnjë e më të mira. "Me anë të kësaj "Marrëveshje Bashkëpunimi", e cila erdhi si përgjigje e ftesës së Ministrisë së Bujqësisë, drejtorit sistemit bankar dhe më gjerë, shumë shpejt disa banka të nivelit të dytë duke mbështetur një pjesë të risikut, duke i bërë ato më "dorëlëshuar", në dhënie e kredisë fermerëve apo agropërpunuesve. Kjo marrëveshje synon që këto institucione të angazhohen, për t'i dhënë kredi fituesve të AZHBR-së. Kontrata e fituesit me AZHBR-në do të shërbejë si një kolateral, për marrjen e këtyre kredive me kushte lehtësuese.



Projektligji për agroturizmin, opozita shqetësim për pastrimin e parave

Komisioni i Ekonomisë u përfshi nga debatet ndërsa diskutimet devijuan nga tema e ditës, por pavarësisht kësaj projektligji për sistemin e taksave u miratua. Opozita vijoi të akuzojë qeverinë se po lejon futjen e parave të kirit në ekonomi, ndërsa projektin e teatrit e cilëson një mundësi për pastrim parash por për kreun e Ekonomisë këto akuzat janë të pavërteta. Projektligji për sistemin e taksave vendore, i cili parashikon një sërë lehtësimesh për të gjithë ata që duan të investojnë në agroturizëm u miratua vetëm me votat e shumicës parlamentare. Opozita e mbështeti idenë, por thotë se diskutimi bëhet në një situatë jo normale dhe ku sipas saj duhet të merren me pastrimin e parave. "E kemi ngritur shqetësimin së fundi se paratë e kirit dhe të drogës po depërtojnë në ekonomi dhe afera e Teatrit Kombëtar është shembulli më i mirë sesi paratë e kirit dhe të drogës do të pastrohen. Ndërtimi në qytetin e Tiranës ka pasur boom dy vitet e fundit, 231 leje ndërtimi të pashpjegueshme" tha Tabaku. "Gjatë 3 mujorit të parë të vitit në të cilin ndodhemi ka kontribuar me një rritje vetëm 0.17 pikë % në rritjen ekonomike të vendit ndërkohë që aktiviteti i pasurive të paluajtshme praktikisht në rast se do të ndodhte pikërisht aty do të materializohej pastrimi i parave të pista. Është rritur në tre muaj vetëm 0.01 pikë %"-argumentoi Braçe.

Ndërhyrja në treg, BSH bleu

19.3 mln euro në tremujorin e parë

Banka e Shqipërisë ka blerë 19.3 milionë euro në tre muaj valutor vetëm në tremujorin e parë të këtij viti. Sipas të dhënave të publikuara nga banka qendrore mbi ndërhyrjet në tregun e parës, në dy ankdet e zhvilluara në shkurt dhe mars shuma e blerë ka shkuar edhe përtej parashikimeve. Vitin e kaluar, Banka e Shqipërisë pati blerë 71.2 milionë euro në tregun valutor, në kuadër të procesit të rritjes së rezervës valutore. Pavarësisht nga kjo kërkesë e konsiderueshme, zhvlerësimi i euros ka vijuar, si në tremujorin e parë, ashtu edhe në tremujorin e dytë, madje me ritme më të larta. Ndërhyrjet në tremujorin e dytë do të bëhen publike me rreth tre muaj vonesë, ashtu siç është praktikë e Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, në kalendarin e ndërhyrjes banka qendrore ka pasur të planifikuara tri ankande të tjera për blerjen e euros, me qëllim rritjen e rezervës valutore. Veç këtyre ndërhyrjeve të planifikuara më parë, në muajin qershor janë zhvilluar edhe operacione të tjera për blerje valute, të orientuara shprehimisht në frenimin e mbicimit të lekut kundrejt euros. Kjo u vendos në mbledhjen e qershorit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me argumentin që forcimi i shpejtë i lekut po neutralizonte presionet e jashtme inflacioniste. Së fundmi, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë duket se kanë arritur ta stabilizojnë kursin e këmbimit të euros pranë nivelit të 126 lekëve. Sipas kursit zyrtar të këmbimit, euro u këmbye të martën me 125.88 lekë. Duke filluar nga java e kaluar, luhatjet në kursin euro-lek kanë qenë të papërfillshme dhe, të paktën për momentin, synimi i bankës qendrore është arritur.



"Kemi protestuar disa herë për kushtet skandaloze, askush nuk merr masa"

Voltiza Duro

Mure të kalbur nga lagështia, dyshekë të vjetër me susta të dala e hapësira të ngushta, ku mungon ajrosja janë streha që shteti iu ofron rreth 5 mijë të rinjve në Qytet Studenti. Godinat kryesore të këtyre konvikteve, të ndërtuara rreth viteve 1960, duket se me zor po i rezistojnë peshës së viteve, edhe për vetë faktin se nuk kanë pasur një restaurim të plotë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Ervis Gega, student e njëkohësisht aktivist i lëvizjes "Për Universitetin" tregon mbi kushtet e mjerueshme në të cilat jetojnë studentët që nuk arrijnë të përballojnë dot qiratë e larta të shtëpive. E vetmja zgjidhje për ta është të paguajnë këtë "keqtrajtim" kundrejt shumës prej 45 mijë lekësh të vjetra në muaj, duke shpresuar që vitet e universitetit të kalojnë sa më shpejt, ose të mund të sigurojnë paratë që nevojiten për të kaluar në një shtëpi në periferi. Studenti 20-vjeçar rrëfen më tej se në dimër shumë herë i është dashur të lahet edhe me ujë të ftohtë, pasi dushet punojnë me orar të limituar, ndërkohë që theksos se dyshekët janë të vjetër e me susta të dala. Jo pak herë, studentët kanë ngritur zërin për t'i dhënë një zgjidhje situatës, por deri më tani ankesat e tyre kanë rënë në vesh të shurdhët. Ndërkohë, edhe studentët të tjerë shprehin për "GSH", se kushtet në të cilat ata jetojnë janë ferri vetë.


Prej sa kohësh jetoni në konviktin e Qytetit Studenti?

Prej janarit të vitit 2018 jetoj në një prej dhomave në konviktet e Qytetit Studentit. Para se të shkoja në konvik, jetoja në një shtëpi me qira, që ishte pak larg dhe duke qenë se nuk kisha mundësi të gjeja shtëpi tjetër më afër me çmim të arsyeshëm e të përballueshëm, u detyrova të futem në konvik të shtetor. Paga për një muaj në konvik është 45 mijë lekë të vjetra.

Si paraqiten kushtet në konvik, a janë të përshtatshme për një jetesë normale?

Studentët: Jetojmë në ferr, konviktet të parikonstruktura prej 6 dekadash

Ervis Gega: Dyer dhe banja të shkatërruara, lahemi me ujë të ftohtë



Pamje nga godina e Qytetit Studenti



Mesa unë kam informacion, 4 godinat e para të konvikteve në Qytet Studenti janë ndërtuar rreth viteve 1960, me hapjen e Universitetit të Tiranës. Më pas janë ndërtuar edhe disa godina të tjera. Por që prej asaj kohe, këto godina ku rrinë studentët nuk kanë marrë asnjë restaurim të plotë, por thjesht janë lyer me bojë e janë bërë riparime të vogla. Ka mure e pllaka të vjetra, aq sa bien dhe suvatimet në tokë.

A është e mjaftueshme hapësira në dhomën ku jetojnë dhe sa të përshtatshme janë ato?

Çdo dhomë ka 3 komodi, 3 krevate, 3 karrige e 3 dyshekë të vjetër. Këta të fundit janë tejet të konsumuar e me susta e tela të dala. Vlen të theksoj se as orenditë nuk janë ndryshuar. Çarçafët që kanë sjellë, janë të grisur dhe nuk ka as lavatriçe, as frigorifer.

Ushqimet që mund të marrim nga familjet në dimër, mund t'i futim në raftin e rrabave, ose në komodinat që mbajmë librat. Nuk ka një dollap ose tavolinë të posaçme që të mund të vendosim ushqimet. Ka një lavaman e një pasqyrë, ndërsa instalimet elektrike janë tejet të këqija. Ka vetëm një prizë e ndriçimi është i dobët. Edhe dyert janë copë-copë e duket sikur do bien në tokë nga momenti në moment. Ndërkohë një konvikti ka rreth 150 studentë, e duhet të ketë pastruese 24 orë, por ambienti është i vjetër e mban vetvetiu mbe-

turina.

Çdo dhomë ka dushin e vet apo janë të përbashkëta, si ia bëni për t'u larë?

Banjat e dushet janë të përbashkëta. Dushet janë me orar, prej orës 13.00 deri në 18.00, por ky është një problem shumë i madh, sidomos për studentët që pas mësimin shkojnë edhe në punë. Ata vijnë në orën 22.00 në dhomë, por ujë në këtë orar nuk ka e kështu nuk kanë mundësi për t'u larë. Në dimër, deri në orën 14.00-15.00 mund të lahen me ujë të ngrohtë rreth 15 vetë, por pastaj sa vjen e ftohet. Unë personalisht që kam mbar-

ar mësimin pas orareve që përmenda, zakonisht jam larë me ujë të ftohtë.

Si janë çmimet e men-save ku ju ushqeheni, a janë ndopak të përballueshme për një student?

Mensat janë private, por çmimet janë disi më të arsyeshme në krahasim me zonat e tjera të Tiranës.

Vetë ju si student dhe aktivist i lëvizjes "Për Universitetin" a i keni bërë ndonjë kërkesë administratës qendrore në lidhje me problematikat e sipërpërmendura?

Lëvizja "Për Universitetin" ka organizuar disa aksione mjaft të rëndësishme në lidhje me problemet e kushtet e këqija në konviktet e Qytetit Studenti. Vetë administrata qendrore është në dijeni të situatës, por për t'i dhënë zgjidhje, normalisht që duhen fonde. Shteti nuk iu jep fonde e lekët që ne paguajmë për konvik-

tin, besoj se shkojnë për punëtorët e administratës, për mirëmbajtjen. Ne kemi bërë një takim para një muaji të sheshi "Demokracia", i cili nuk u prit mirë. Pas kësaj ndërmorëm një aksion me disa banderola për t'u treguar pushtetarëve gjendjen e mjerueshme ku jetojnë studentët në këto konvikte. Por sërish hasëm në kundërshtime nga administrata e nga policia e Qytetit Studenti.

Ju personalisht si do veproni, do vazhdoni të qëndroni në konvik, apo e shikoni si një zgjidhje më të mirë shtëpinë me qira?

Faktikisht është e vështirë të gesh një shtëpi me qira, sepse çmimet përgjithësisht janë të larta, por mendoj se vitin tjetër do e gjej një ambient me qira për të jetuar, qoftë edhe në periferi të Tiranës.

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbarimore L.D.C

"Trulli" - ndërtesë, me nr pasurisë 31/12, ZK 3428, vol 5, fq 3 me sipërfaqe totale: trulli 1.837 m2 dhe sipërfaqe ndërtese 260.6 m2 me adresë fshati Shtoj i Ri, Shkoder. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Shkoder ne emer te Zako Spaso Ajkovic. Çmimi fillimtar per shitje eshte: 22.400.000 Lekë.

Data e shpalljes: 21.06.2018
Data e zhvillimit: 13.07.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

**VENDIMI
TAPITE**

Llogariten sipërfaqet takuese për pronarët, poseduesit marrin tapinë

Qeveria miraton të drejtën mbi pronën për 280 ndërtime

Lista me përfituesit në të gjithë vendin

Ornela Manjani

Këshilli i Ministrave ka miratuar të drejtën për kalimin e pronësisë të parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale. Bëhet fjalë për 280 parcela ndërtimore në të gjithë vendin, kur personat që kanë ndërtuar pa leje do të marrin tapinë mbi truallin. Sipas listës së miratuar nga qeveria dhe të botuar në Fletoren Zyrtare mësohet se është përlogaritur sipërfaqja takuese ku në pjesën më të madhe të rasteve ka ndryshime në m2 që përfitojnë pronarët.

TAPIA

Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZINI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarimin e procesin të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të



Foto ilustruese

cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së ba-

zës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi ma-

sat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytë-

zohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratu-

ar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

LISTA ME PËRFITUESIT

SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)																																								
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10																																								
LIVRA A																																																	
<table border="1"> <thead> <tr> <th>SHIFTE</th> <th>EMRI</th> <th>ADRESA</th> <th>MBRESA</th> <th>NR. FUNKSIONALE</th> <th>ZONJA KATEGORIALE</th> <th>NR. FUNKSIONALE</th> <th>SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m²)</th> <th>VLERE E TRUALLIT (qindese)</th> <th>VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>1</td> <td>147</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>2</td> <td>148</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>3</td> <td>149</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> </tbody> </table>										SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)	1	ASLAN	CEKESH	1	147	1261	2096	1000,782	3096	3097,782	2	ASLAN	CEKESH	2	148	1261	2096	1000,782	3096	3097,782	3	ASLAN	CEKESH	3	149	1261	2096	1000,782	3096	3097,782
SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)																																								
1	ASLAN	CEKESH	1	147	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								
2	ASLAN	CEKESH	2	148	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								
3	ASLAN	CEKESH	3	149	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								
LIVRA B																																																	
<table border="1"> <thead> <tr> <th>SHIFTE</th> <th>EMRI</th> <th>ADRESA</th> <th>MBRESA</th> <th>NR. FUNKSIONALE</th> <th>ZONJA KATEGORIALE</th> <th>NR. FUNKSIONALE</th> <th>SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m²)</th> <th>VLERE E TRUALLIT (qindese)</th> <th>VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>1</td> <td>147</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>2</td> <td>148</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>3</td> <td>149</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> </tbody> </table>										SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)	1	ASLAN	CEKESH	1	147	1261	2096	1000,782	3096	3097,782	2	ASLAN	CEKESH	2	148	1261	2096	1000,782	3096	3097,782	3	ASLAN	CEKESH	3	149	1261	2096	1000,782	3096	3097,782
SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)																																								
1	ASLAN	CEKESH	1	147	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								
2	ASLAN	CEKESH	2	148	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								
3	ASLAN	CEKESH	3	149	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								
LIVRA C																																																	
<table border="1"> <thead> <tr> <th>SHIFTE</th> <th>EMRI</th> <th>ADRESA</th> <th>MBRESA</th> <th>NR. FUNKSIONALE</th> <th>ZONJA KATEGORIALE</th> <th>NR. FUNKSIONALE</th> <th>SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m²)</th> <th>VLERE E TRUALLIT (qindese)</th> <th>VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>1</td> <td>147</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>2</td> <td>148</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>ASLAN</td> <td>CEKESH</td> <td>3</td> <td>149</td> <td>1261</td> <td>2096</td> <td>1000,782</td> <td>3096</td> <td>3097,782</td> </tr> </tbody> </table>										SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)	1	ASLAN	CEKESH	1	147	1261	2096	1000,782	3096	3097,782	2	ASLAN	CEKESH	2	148	1261	2096	1000,782	3096	3097,782	3	ASLAN	CEKESH	3	149	1261	2096	1000,782	3096	3097,782
SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)																																								
1	ASLAN	CEKESH	1	147	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								
2	ASLAN	CEKESH	2	148	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								
3	ASLAN	CEKESH	3	149	1261	2096	1000,782	3096	3097,782																																								

SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)
1	ASLAN	CEKESH	1	147	1261	2096	1000,782	3096	3097,782
2	ASLAN	CEKESH	2	148	1261	2096	1000,782	3096	3097,782
3	ASLAN	CEKESH	3	149	1261	2096	1000,782	3096	3097,782

SHIFTE	EMRI	ADRESA	MBRESA	NR. FUNKSIONALE	ZONJA KATEGORIALE	NR. FUNKSIONALE	SIPERFAQJA PER KOMPENSIM (m ²)	VLERE E TRUALLIT (qindese)	VLERE E SHPERBLIMIT (qindese)
1	ASLAN	CEKESH	1	147	1261	2096	1000,782	3096	3097,782
2	ASLAN	CEKESH	2	148	1261	2096	1000,782	3096	3097,782
3	ASLAN	CEKESH	3	149	1261	2096	1000,782	3096	3097,782

ITALI - Identifikohen dy shqiptarët, të cilët u arrestuan dy ditë më parë, pasi akuzohen se plagosën me thikë djalin e prezantueses së njohur italiane, Simona Ventura. Mediat italiane shkruajnë se bëhet fjalë për Andi Arapin, 29 vjeç, me qëndrim ilegal në Itali dhe 24-vjeçarin Albano Jakey. Mësohet se 19-vjeçari Nicolò Bettarini,



Goditën 11 herë me thikë djalin e prezantueses italiane Simona Ventura, identifikohen 2 shqiptarët

djali i moderatores italiane Simona Ventura dhe ish-futbollistit Stefano Bettarini u qëllua 11 herë me thikë dhe mbeti i plagosur pas një shërri me një grup të rinjsh në një diskotekë

'Old Fashjon' të Milanos. "Të njohëm, je i biri i Bettarinit, do të vrasim", - kështu mësohet t'i ketë thënë një nga të rinjtë që e qëllloi më pas me thikë. Fatmirësisht i riu është jashtë

rrezikut për jetën, ndërsa dy shqiptarët do të përballen me drejtësinë. Mes të arrestuarve janë edhe Davide Caddéo, 29 vjeç dhe Alessandro Ferzoco, 24 vjeç.

Trafikantët e merrnin drogën në Holandë dhe e hidhnin në tregun italian

Shkatërrohet banda e trafikut të kokainës në Itali, përfundojnë në pranga 22 persona

Operacioni, mes të arrestuarve 10 shqiptarë

ITALI

Policia italiane ka shkatërruar një bandë shqiptaro-arabe që merrej me trafikimin e kokainës nga Holanda për në Itali. Mësohet se gjatë operacionit "Sottobosco", që u krye mëngjesin e djeshëm në zonën e Emilia Romanjas dhe Toskanës u bënë mundur shkatërimi i bandës shqiptaro-arabe, që kishte shtrirje në disa zona të Italisë dhe përkatësisht në Emilia Romagna, Toscana, Lombardi dhe Sicili. Në pranga kanë përfunduar 22 persona, mes të cilëve 10 shqiptarë. Bëhet fjalë për shtetasit Dëfrim Dervishi, Haxhi Dervishi, Enver Dervishi, Besnik Dervishi, Klodian Alushku, Olsi Ivziku, Shkëlzen Cani, Arjan Temaj, Festim Hoxha dhe Shpëtim Fili. "livesicilia.it" shkruan se grupi e merrte kokainën nga Holanda dhe më pas e shpërndante atë në tregun italian. Karabinierët e komandës së Ferraras-s, së bashku me kolegë nga Bolonia, Modena, Parma, Brescia, Mantova, Firenze, Pisa dhe Pistoia ekzekutuan urdhrin për arrestimin e 22 personave, të cilët ndodhen në paraburgim. Sipas mediave të vendit fqinj, hetimet për operacionin në fjalë kishin nisur që në vitin 2016, ndërsa provat vërtetuan edhe aktivitetin e paligjshëm të kësaj bande, e cila ishte e specializuar për tregtinë e kokainës së importuar nga Holanda. Po të njëjtat burime bënë me dije se kokaina e importuar nga Holanda shitej në Itali rreth 80 euro për gram, ndërsa një kilogram bluhej me shumicë për 35 mijë euro.



SHKURT

13-vjeçari gjendet i varur në pemë, policia:

Ngjarja, aksidentale
DIBËR - Një i mitur i ka dhënë fund jetës duke u vetëvarur në një pemë. Ngjarja ka ndodhur të hënën në njësinë administrative Maqellarë të Dibrës. Sipas burimeve policore, viktima është 13-vjeçari me inicialin ER.. Mësohet se nga hetimet paraprake, në trupin e të miturit nuk janë konstatuar shenja dhune. "Rreth orës 11:40, datë 02.07.2018, Policia e Dibrës është njoftuar se në njësinë administrative Maqellarë është gjetur i vetëvarur në një pemë i mituri ER., rreth 13 vjeç. Grupi hetimor vijon hetimet në vendin e ngjarjes për zbardhjen e rrethanave të kësaj ngjarjeje. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibrë si ngjarje aksidentale", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Dibrës.

Tenton të vjedhë banesën e dhunon pronarin, kapet 32-vjeçari

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka prangosur një 32-vjeçar, pasi po tentonte të vjedhte në një banesë. Ngjarja në fjalë ka ndodhur në fshatin Mlizë të këtij rrethi. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se bëhet fjalë për Etmond Panxhin, ndërsa ai akuzohet se hyri në banesën e shtetasit me inicialin B.T., 64 vjeç, i cili ndodhej i vetëm në banesën e tij, ku i ka kërkuar para dhe më pas e ka goditur me sende të forta. Falë reagimit të kohës të shërbimeve të Policisë dhe ndërhyrjes profesionale është bërë e mundur kapja dhe arrestimi në flagrancë i agresorit. Materialet në ngarkim të Etmond Panxhit i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprën penale, "Vjedhje me dhunë e mbetur në tentativë". Pritet që tëgotat e zezë të këtij qyteti të vendosin masën e sigurisë ndaj 32-vjeçarit.

Shërri, 57-vjeçari plagos me sende të forta bashkëshatarin

MALIQ - Një 65-vjeçar ka mbetur i plagosur pas një shërri për motive të dobëta me bashkëshatarin e tij. Ngjarja në fjalë ndodhi dy ditë më parë në fshatin Leminot të bashkisë së Maliqit. Burime zyrtare nga policia vendore e Korçës bënë me dije se shtetasi me inicialin H.B., 57 vjeç, dyshohet se ka goditur me sende të forta bashkëshatarin e tij, shtetasin me inicialin, Sh.B., vjeç 65, banues në Leminot. Ndërkohë, materialet në ngarkim të autorit të dyshuar i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për veprimet mëtejshme hetimore.

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 4 Korrik 2016

GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Eliminimi i Danimarkës nga Botërori, ironizon ish-deputetja e PS
- Haradinaj feston ditëlindjen, bashkëshortja: Jam dhurata jote më e mirë!
- Çelja e negociatave, Këllici publikon "meme" me thinja për Bushatin
- Irani akuzon Izraelin se i ka vjedhur shiun dhe dëborën!


Më e nxehtë se kurrë,
Einxhel Shkira djeg
'Instagramin'



Si dy motra të pandara,
Alketa Vejsiu vijon pushimet
me vajzën e Vera Grabockës



Nga Ana Lika tek Xhensila Pere, ja personazhet e njohura që kanë pranuar ndërhyrjet



"I dashur kirurg plastik...", VIP-at që kanë ndryshuar rreñjesisht

Tendenca e buzëve dhe vitheve të mëdha,
ja të famshmit shqiptarë që u 'infektuan'

Nga Ana Lika tek Xhensila Pere, ja personazhet e njohura që kanë pranuar ndërhyrjet

"I dashur kirurg plastik...", VIP-at që kanë ndryshuar rrënjësisht

Tendenca e buzëve dhe vitheve të mëdha, ja të famshmit shqiptarë që u 'infektuan'



Pamela Aliaj

Fakti se shumë njerëz kërkojnë të bëjnë ndërhyrje në pamjen e tyre të jashtme nuk përbën më ndonjë risi dhe as nuk është diçka që e diskutojmë për herë të parë. Por fakti se një 'sëmundje' e tillë është tepër e përhapur këtë dekadën e fundit, përbën një problem të thellë në shoqërinë tonë. Shembulli që ne marrim në jetën tonë të përditshme, të paktën shumica prej nesh, janë personazhet e njohur, të ashtuquajturit persona VIP. Ky 'model' i yni merret jo vetëm në veshje dhe në stilin që ata kanë, por, gjithashtu, edhe në pamjen e tyre. Nuk mund të themi se janë të pakta tendencat e tyre për t'u deformuar, një mundësi e artë kjo për kirurgët plastikë në vend. Tendenca e cila është bërë virale në gjithë botën nuk kishte se si të mos përfshinte edhe vendin tonë të vogël. Janë vetë VIP-at tanë ata që nuk mundën t'i rezistojnë tundimit të injektimit të gjilpërës në buzë, të ashtuquajturën lipfiller, apo në mollëza apo edhe në sy, pa harruar zvogëlimin e hundës dhe heqjen totale të rruhdave duke bërë 'ngrirjen' e lëkurës. Pra me pak fjalë, duke përfshirë rastet kur një ndërhyrje në fytyrë ka



qenë e nevojshme edhe nga ana estetike, të tjerat mund të themi pa pikë dyshimi se i kanë kthyer VIP-at tanë në kopje të njëri-tjetrit duke pasur frikë t'i identifikojmë. Duke qenë se fryrjet bëhen nga të gjitha anët e pjesët e trupit, duke u kthyer kështu në një kukull Barbie plastike pa

asnjë lloj mimike në fytyrë apo shprehjeje që të të identifikojë nga të tjerët. Pra, "e dashur gjilpërë dhe bisturi"... nga t'ia fillojmë më parë me VIP-at tanë shqiptarë për të nisur listën e gjatë të atyre që kanë ndryshuar rrënjësisht dhe nuk kanë dashur asnjëherë që ta pranojnë një gjë të tillë.


Më poshtë do t'ju listojmë disa prej tyre duke përfshirë edhe vetë fotot e tyre të krahasuara me ato të disa viteve më parë do të nxjerrin në pah atë që vetë VIP-at mundohen ta mohojnë, edhe pse duhet të theksojmë se disa prej tyre e kanë pranuar publikisht ndërhyrjet e bëra në fytyrën e tyre. Për-

mendim këtu aktoren Anais Lika për ndërhyrjen e bërë në buzë apo ish-banoren e 'Big Brother 9', Xhensila Pere, për ndërhyrjen e bërë në hundë, apo edhe ish-banoren tjetër të 'Big Brother', Françeska Jaçe, për ndërhyrjen e bërë në hundë. Gjithashtu edhe këngëtarja Çiljeta Xhilaga ka pran-

uar se bën ndërhyrje në mjekër për ta shtuar atë, gjithashtu, ka pranuar se para dy vitesh bëri ndërhyrje në gjoks për ta zvogëluar atë. Pra, përveç VIP-ave 'që fshihen' kemi edhe nga ata që s'e kanë problem ta pranojnë. Ja disa prej atyre që kanë ndryshuar 'look' tërësisht me ndërhyrjet e bëra:

TURNI I DYTË I PUSHIMEVE, JA DESTINACIONI I RADHËS PËR RUDINA DEMBACAJ

Edhe pse shumica prej nesh nuk i kanë nisur pushimet, disa të tjerë kanë mundësi të bëjnë të dytat. Kjo është pikërisht aktorja e njohur shqiptare, Rudina Dembacaj. Kësaj radhe nuk është nisur me familjen, por me shoqet. Dhe destinacioni i preferuar për vajzat ka qenë pikërisht Spanja. Nëpërmjet një fotoje të hedhur në "Instagram" disa foto ku së bashku me shoqet po prisnin avionin për t'u nisur për në Madrid të Spanjës. Pas Turqisë tashmë aktoren e presin disa ditë të tjera fantastike relaksi në tokën latine të Spanjës.



MË E NXEHTË SE KURRË, EINXHEL SHKIRA DJEG 'INSTAGRAMIN'

Përej një kohe të gjatë Einxhel Shkira ishte duke u marrë me palestër për t'u rikthyer në formë për verën e nxehtë që sapo ka filluar. Tashmë larg ushtrimeve dhe fitnesit të përditshëm, ish-moderatorja shfaqet në një formë fantastike të trupit të saj me rroba banjo. Mesa duket dieta e veçantë dhe ushtrimet i kanë bërë shumë mirë bukuroshes e cila shfaqet më seksi se kurrë. Në fotot e postuara në faqen e saj në 'Instagram' duket se dhe vetë Einxhel ndihet shumë mirë me trupin e saj. Edhe pse të themi të drejtën nuk është se ka patur shumë nevojë, ajo sërish një femër tërheqëse dhe shumë seksi mbetet.




E LUMTUR DHE PA "MAKE UP", AMI SHFAQET SI E KA BËRË NËNA


Pas pushimeve të kaluara me familjen në Turqi, Amarda Toska është rikthyer në Tiranë për t'u rikthyer punës e impenjimeve të përditshme. Por pavarësisht të gjithave, ajo shijon edhe pak kohë relaks për veten. Në foton e hedhur së fundmi në 'Instastory' Ami shfaqet ujë e sapun dhe shumë e qeshur para kamerës e shtrirë në barin e gjelbër. "Një natyrën" shkruan mbi foto Ami së cilës duket se i kanë bërë shumë mirë pushimet në Turqi dhe kjo vihet re lehtë në nurin e qetësinë që ka marrë në fytyrë.



SI DY MOTRA TË PANDARA, ALKETA VEJSIU VJON PUSHIMET ME VAJZËN E VERA GRABOCKËS

Nuk u mjaftoi aventura afrikane që kaluan së bashku moderatorja Alketa Vejsiu dhe vajza e regjisorës së njohur, Vera Grabocka, Linda. Mesa duket një eksperiencë e tillë u shijoi në maksimum dhe mesa duket ato nuk dinë të ndahen. Kjo vihet re edhe në një postim të bërë së fundmi nga Alketa ku ka publikuar një foto ku shfaqen të dyja me rroba banjo duke shijuar rrezet e diellit. Duket se këto ditë pushimesh ato do vijojnë t'i kalojnë së bashku sërish si dy motra të pandara.





12 RREGULLAT

për t'u dobësuar

3 kilogramë në javë në

mënyrë të shëndetshme

Nëse jeni në kërkim të një diete për të arritur peshën tuaj ideale, kjo nuk do të thotë patjetër se duhet të vuani nga uria. Mjafton të keni vullnet e të ndiqni disa nga rregullat kryesore që dietologët rekomandojnë.

Ja cilat janë këshillat për të humbur deri në 3 kilogramë në javë në mënyrë të shëndetshme:

PINI SA MË SHUMË UJË GJATË DITËS
Uji nuk ka kalori dhe është një hidratues i përkryer dhe ju nevojiten të paktën 8 gota uji natyral në ditë. Mos e zëvendësoni atë me lëngjet e frutave, pasi pavarësisht se lëngjet janë shumë të shëndetshme, mos harroni se përmbajnë kalori dhe nëse e teproni me to, mund ta teproni me karbohidratet pa e vënë fare re.

LARGONI PLOTËSISHT NGA MENYJA BUKEN E BARDHË, ORIZIN DHE PASTËN

Ju do të keni mundësi të arrini peshën ideale vetëm nëse dini të distancoheni nga "mëkati i bardhë" siç janë: buka e bardhë, sanduiçet, orizi i bardhë dhe pasta po me miell të bardhë. Dhe, nëse doni të humbisni në peshë, mos e zëvendësoni miellin e bardhë me atë integral, por me perime të shëndetshme. Për shembull, nëse doni të konsumoni një sanduiç me pulë dhe majonezë, tashmë mund të konsumoni një sallatë jeshile me fileto pulë, pomodorini, kastravec, misër etj, pra një pjatë me shumë vlera ushqyese dhe

që ju mban në formë.
LARGONI PLOTËSISHT NGA MENYJA PIJET E GAZUARA DHE LËNGJET E KONSERVUARA
Pijet e gazuara dhe lëngjet e konservuara të frutave nuk duhet të kenë aspak vend nëse keni vendosur të arrini linjat tuaja perfekte trupore, pasi përveç se ato janë të dëmshme për shëndetin për shkak të përmbajtjes së tyre, ato kanë edhe një sasi shumë të lartë sheqeri industrial si dhe kanë shumë kalori.
SAKRIFIKONI TË PAKTËN NJË USHQIM NGA ZAKONI JUAJ DITOR
Nëse jeni mësuar të konsumoni patatina gjatë orarit të punës apo një ëmbëlsirë pas darkës, mundohuni të hiqni fillimisht dorë nga njëra prej tyre. Pas disa kohësh ju do të harroni fare se më parë e konsumoni atë çdo ditë.

KONSUMONI PESHK SALMON NË NJË VAKT GJATË DITËS
Salmoni është i pasur me shumë vlera ushqyese dhe me shumë acide yndyrore Omega 3 dhe ka një ndikim shumë pozitiv në shëndetin dhe në lëkurën dhe pamjen



tuaj. Prandaj mundohuni që njërin nga vakdet në ditë ta keni peshk salmon.
BËNI KARDIO TË PAKTËN 30 MINUTA NË DITË
Për të rënë deri në 3 kilogramë në peshë gjatë një jave, nuk mjafton vetëm dieta, por edhe ushtrimet fizike. Mundohuni patjetër të bëni kardio në palestër ose ecje në natyrë të paktën 30 minuta në ditë.
PINI NJË KAFE NJË ORE PARA PALESTRËS
Sipas studimeve, nëse ju pini një kafë një orë përpara palestrës, do të ndiheni shumë më tepër energjikë

dhe do të përballoni shumë më lehtë aktivitetin në palestër, duke ndihmuar kështu veten në djegien e kalorive.

FLINI GJYSMË ORE MË SHUMË ÇDO DITË

Një gjumë i mirë ka një ndikim kryesor në metabolismin dhe mirëqenien tuaj të përgjithshme shëndetësore. Prandaj nëse doni të bini në peshë, mundohuni të shkoni në shtrat gjysmë ore më parë, deri sa të arrini kohën ideale të gjumit, që është 7-8 orë në ditë.

QËNDRONI DREJT
Mund t'ju duket e pa vend, por qëndrimi me trupin drejt është shumë i rëndësishëm jo vetëm në aspektin estetik, por ai shmang edhe deformimet e shumta apo akumulimin e shëndetit dhe dhjamtit në zona të caktuara.
BËNI 36 ULJE NGRITJE NË DITË

Edhe pa patur nevojë të shkoni në palestër, mundohuni të bëni 3 seanca me nga 12 ulje ngritje çdo ditë, për të forcur në këtë mënyrë njëkohësisht muskujt e barkut, të këmbëve dhe të vitheve.

CLIROHUNI NGA FRYRJA E BARKUT
Nëse vuani nga fryrja e barkut apo keni problem me gazrat, drejtohuni në farmaci apo në dyqanet me bimë medicinale, pasi nëse sistemi juaj tretës ka probleme ju nuk do të ndiheni aspak mirë me veten dhe do të ndiheni shumë të lodhur e të pa motivuar për të kaluar një ditë sa më aktive dhe me energji.

DREJTOJENI JU SEKSIN
A e dini se në një pozicion aktiv gjatë seksit, kur jeni ju partneri që drejtoni dhe bëni lëvizjet kryesore, harxhoni rreth 150 kcal në 30 minuta? Prandaj edhe seksi i mirë është një faktor shtesë për të rënë në peshë. Përveç kësaj, gjatë seksit çlirohet endorffina, hormoni i lumturisë, i cili veç të tjerash ndikon edhe në largimin e toksinave nga organizmi.



BULEVARDI

POLITIK

Në merrni seriozisht!

Eliminimi i Danimarkës nga Botërori, ironizon ish-deputetja e PS: E dashtun, ai që t'i priti penalltitë është arbëresh

Kroaci-Rusi do të jetë çerekfinalja tjetër e këtij Botërori. Kjo pasi kroatët u kualifikuan pas një ndeshje dramatike me Danimarkën pas penalltive, ndërsa 120 minuta loje u mbyllën 1-1. Këtë ndeshje e ka komentuar edhe ish-deputetja e PS Ledi Shamku. Ish-deputetja ironizon duke u shprehur se portieri kroat që priti golat e danezëve është arbëresh. Ndërsa në fund Shamku i kujton Danimarkës edhe çështjen e negociatave të Shqipërisë. "E dashtun Danimarkë, ai që t'i priti penalltitë sot e të çoi "tu shpajja", portieri Daniel Subasi?, është arbëresh i Zarës. E kshu, rrugës së kthimit, ec e ec, kadalë e kadalë, menojë dhe iher at punën e negociatave po mujte #forcaKroacia", mbyll komentin e saj, ish-deputetja.



Çelja e negociatave, Këlliçi publikon "meme" me thinja për Bushatin

Shqipërinë po e mban peng krimi dhe korrupsioni i Edi Ramës!" Kështu shkroi kreu i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, Belind Këlliçi ndërsa sulmon ministrin e Jashtëm Ditmir Bushati për mos hapjen e negociatave. Sipas Këlliçit, Bushati gënjen pasi siç shkruan ai, negociatat nuk janë hapur dhe Këshilli Europian nuk e ka shqyrtuar fare si çështje. Kreu i FRPD e shoqëron postimin e tij me këtë foto të Bushatit, të plakur nga pritja e gjatë. "Ditmir Bushati gënjen dhe as nuk skuqet e as nuk zverdhët. Negociatat jo vetëm që nuk janë hapur, por Këshilli Europian që është vendimarrësi as nuk e ka shqyrtuar fare si çështje. Shqipëria nuk u la as për vjeshtë, por do përsërisë gjithë vitet sepse qeveria s'ka plotësuar asnjë kriter, perkundrazi është kriminalizuar, hashashizuar, kokainizuar dhe korrupsuar deri në palcë", u shpreh Këlliçi, duke e ilustruar me këtë foto të Bushatit.



Haradinaj feston ditëlindjen, bashkëshortja: Jam dhurata jote më e mirë!

Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj kishte dje, dy festa 14 vjetorin e martesës dhe ditëlindjen. Bashkëshortja e tij Anita Mucaj e ka uruar me anë të një postimi në 'Facebook' ku nuk mungonte humori. Në shkrimin që i ka dedikuar, theksoi se dhurata e tij më e mirë vazhdon të mbetet ajo. "Historitë tona vështirë se mund t'i kuptosh nëse nuk i ke provuar, sot edhe ndoshta mund ta kemi flakur romantizmin tutje, por kemi 14 vjet bashkë dhe sot festojmë dy festa, sot kur ne jemi më shumë se familje, me shumë se të dashur, më shumë se çift, sot jemi unë ti dhe tre fëmijë!!! Sot në mos asgjë përfaqësojmë shumë dashuri brenda botës tonë të vogël me të mirat dhe të këqijat që dashuria i ngërthen në vete!!! Gëzuar Ramush Haradinaj!! Të duam shumë Gjini, Hana, Trimi e unë edhe ma shumë!!! P.s vazhdoj të mendoj që jam ende dhurata ma e mirë që ndonjëherë e ke marrë për ditëlindje!!Përveç Ditëlindjes, Gëzuar edhe 14 vjet martesë (vështirë boll ama punë qejfi burrë)", shkroi Anita Haradinaj.



Irani akuzon Izraelin se i ka vjedhur shiun dhe dëborën!

Ndërsa Irani po vuan prej thatësisë nga më të rëndat, zyrtarët e saj po përpiqen të shpjegojnë kushtet katastrofike të motit. Një gjeneral iranian beson se Izraeli është pas rrëmbimit të reve dhe borës, por meteorologët hedhin dyshimet e tyre. Gjeneral brigade Gholam Reza Jalali, kreu i Organizatës së Mbrojtjes Civile të Iranit, akuzoi kundërshtarin e vjetër rajonal, Izraelin se ka marrë drejtimin e ndryshimit të "dyshimit" të klimës në vend. Gjenerali thotë se hulumtimet kanë dhënë dëshmi se Tel-Aviv, me disa aleatë, po ndikojnë tek ndryshimi i reshjeve në tokën iraniane. Duke hedhur fajin tek Tel Avivi, ai tha se "ekipet e përbashkëta nga Izraeli dhe një nga vendet fqinje bëjnë që retë të hyjnë në Iranin shterpë. Për më tepër, ne jemi përballur me rastet e vjedhjes së reve dhe vjedhjes së dëborës". Sidoqoftë, shërbimi meteorologjik i Iranit ka dyshimet e tij lidhur me pretendimin, duke thënë se Irani nuk është i vetmi vend që vuan nga thatësira e tej zgjatur pasi ajo "është një prirje globale".

BULEVARDI

POLITIK

Në merrni seriozisht!



"Prestige Resort' është fantastik. Pishina, deti, hoteli, të gjitha janë në perfeksion"

AURORA GOLEMI

DURRËS

Shqipëria "çmend" turistët e huaj: Nuk e prisnim këtë mrekulli, jemi të befasuar!

"E identifikonim ende me komunizmin apo më keq akoma, me një vend të mafies dhe mafiozëve"

Shqipëria, gjithmonë e më shumë po tërheq si magnet turistët e huaj, të cilët pak ose aspak e njohin vendin e vogël në brigjet e Adriatikut. Mjaft media të huaja që dikur flisnin për një vend komunist, të izoluar e të varfër, me njerëz të paushqyer e të veshur keq, sot i bëjnë jehonë turizmit në Shqipëri, një promovim që mesa duket ka ndikuar në rritjen e numrit të vizitorëve të huaj. Ka mjaft turistë, të cilët janë të dyzuar teksa bëjnë gati valixhet për të ardhur në Shqipëri, por me të zbritur në "këtë cep të Ballkanit" ata surprizohen, sepse ajo që shohin nuk përputhet me atë që kishin dëgjuar e përfytyruar. Kjo kuptohet lehtë teksa i dëgjon të shprehen për Shqipërinë, për Shqipërinë që njihnin më parë dhe atë që njohën kur e prekën vetë. Turistët nordikë që pushojnë në "Prestige Resort" thonë se janë njohur me vendin tonë vetëm nga kronikat e televizioneve të tyre. Ata pranojnë se Shqipërinë e identifikonin me komunizmin apo më keq akoma, me një vend të mafies dhe mafiozëve. Sot ata qeshin dhe shprehen se në fakt Shqipëria është një projektion ndryshe nga ajo çka dinin për të.


TURISTËT

"Në lajmet e vendit tim nuk para dëgjoj shumë lajme për Shqipërinë. Gjëja e vetme që kisha dëgjuar ishte për mafien. Më vjen keq. Por absolutisht po e konsideroj të kthehem sërish këtu në këtë resort, që më pëlqen shumë, është më i miri në këtë vend. E zgjidha se dukej kaq i ri, panorama që ofron, është i pastër dhe komod. Ushqimi është i shijshëm dhe dhomat janë me kushte shumë të mira dhe tepër të pastra. Kur të kthehem në shtëpi, do u them miqve shkoni patjetër në Shqipëri. Ia vlen", thotë një turist.

"Shqipëria ishte surprizë, pasi gjithçka është kaq ndryshe nga ç'është imagjinuar. Ne nuk dëgjojmë shumë lajme në Norvegji për vendin tuaj, por e dimë që keni pasur probleme në të kaluarën, si për shembull vite më parë dëgjonim për komunizmin, por tani është ndryshe. Tani e shohim që nuk është komunizëm. Me këtë që pashë e përjetova unë, dua të kthehem sërish këtu. Madje kemi planifikuar edhe një vizitë në qytetin e Vlorës, agjencia jonë 'Apollo' na ka planifikuar



"Prestige Resort" në Golem



VLERËSIMI

"Vetëm e kishim dëgjuar se keni një bregdet të bukur dhe tani po e shohim vetë. Ne po qëndrojmë në 'Prestige Resort', është një eksperiencë e bukur dhe padyshim që do të rikthehemi këtu", thanë turistët norvegjezë. "Prestige Resort" është një oaz qetësie e argëtimi. Të parët që i besuan emrit të resortit ishin miqtë e largët të vendeve nordike, turistët elitare që vijnë nga vende si Suedia, Norvegjia, Finlanda dhe Danimarka, të cilët kanë ardhur përmes agjencive turistike prestigjioze si 'Apollo' dhe 'Der Turistik' për të njohur një Shqipëri tjetër".

edhe një shëtitje me safari", shprehet një tjetër.

"Jam nga Norvegjia. Deri tani impresionet e para janë shumë të mira. Me thënë të drejtën nuk prisja ndonjë gjë të madhe, duke marrë parasysh se Shqipëria ishte një vend komunist. Nuk prisja nga shumë...", thotë turisti nga Norvegjia.

"PRESTIGE RESORT"

Ndryshe nga hotelet apo resortet përreth, në "Prestige Resort" pushuesit kanë mundësi të zgjedhin mes tri pishinave, drej të cilave janë me ujë të ëmbël, ndërsa e treta me ujë deti, duke e sjellë Adriatikut vetëm pak metra larg dhomës së gjumit. Pushuesit nordikë kanë mbetur të mrekulluar që kanë zgjedhur të pushojnë pikërisht në

"Prestige Resort", i cili është i pozicionuar pranë detit, nën hijen e pishave, me një panoramë mbresëlënëse. Ata thonë se do të rikthehen sërish me më shumë miq.

Një turist thotë se: "Resortin nuk e prisja që të ishte kaq afër me detin, kisha idenë se do ecnim në këmbë, por resorti është ngjitur fare me detin. U surprizova shumë kur e pashë. Dhomat janë të mira. Ushqimi e vërtet i shijshëm, petullat më pëlqyen".

Ndërsa një tjetër shton: "Unë jam nga Suedia, por jetoj në Norvegji. Kam qenë para 5 viteve në Shqipëri. Para se të vija këtu, e dija që bregdeti juaj është i mahnitshëm, ketë përshlyje kisha kur zgjidha të pushoja këtu.

SURPRIZA

"Shqipëria ishte surprizë, pasi gjithçka është kaq ndryshe nga ç'është imagjinuar. Ne nuk dëgjojmë shumë lajme në Norvegji për vendin tuaj, por e dimë që keni pasur probleme në të kaluarën, si për shembull vite më parë dëgjonim për komunizmin, por tani është ndryshe. Tani e shohim që nuk është komunizëm. Me këtë që pashë e përjetova unë, dua të kthehem sërish këtu. Madje kemi planifikuar edhe një vizitë në qytetin e Vlorës, agjencia jonë 'Apollo' na ka planifikuar edhe një shëtitje me safari", shprehet një tjetër.

Por është më bukur, është perfekt, është si një paradisi. Përshlyet për këtë resort i kam shumë të mira, ka disa pishina, sidomos kjo për fëmijë. Më pëlqen që nuk është e mbipopulluar me njerëz, ka qetësi".

"Nuk prisja që turizmi të ishte kaq i zhvilluar, duke pasur parasysh se Shqipëria nuk ka shumë kohë që e zhvillon atë. Këtu hoteli është shumë herë më i madh dhe modern sesa e kisha menduar. Mendoj se do të kthehem sërish, madje me shumë miq me vete, sepse do t'u them që Shqipëria ia vlen të vizitohet", shprehet turisti.

"Për vendin tuaj nuk kisha dëgjuar më parë, prandaj kisha interes të vija këtu. 'Prestige Resort' është shumë

i mirë. Nëse e krahasojmë me hotelet e tjera këtu pranë, mund të them që është më i miri. Miqve dhe të afërmeve do u them të vijnë se është shumë ndryshe në krahasim me shtetet e tjera ku kemi kaluar pushimet", thotë një tjetër.

Teksa relaksohen pranë pishinave e pishave gjysmëshekullore, turistët thonë se cilësia dhe shërbimi bëjnë diferencën në "Prestige Resort", pasi stafi i kualifikuar i kushton rëndësi të veçantë çdo detaji.

"Është më bukur sesa e kisha imagjinuar, pishina, deti, hoteli, të gjitha janë në perfeksion. Dhomat janë kaq të pastra e të rregullta. Kur të kthehem do u sugjeroj njerëzve që njoh të vijnë ta

vizitojnë e të mos stepen nga ato çfarë kanë dëgjuar për Shqipërinë", shprehen disa turistë të tjerë.

"Na pëlqen këtu, është një hotel i mirë dhe me pishina për të rritur dhe fëmijë, madje njëra është me ujë të kripur. Mjafton të zgjedhësh, është kaq afër me detin. Këtu të ofrohet gjithçka. Moti është i mirë, birra është e mirë. Kjo është birra 'Korça', një birrë autentike shqiptare, vërtet e shijshme", pohon një tjetër turist.

Sapo këmba ka shkelur në super resortin "Prestige", në zemër të Golemit, atje ku nxehësia e diellit freskohet nga hija e pishave dhjetëvjeçare, turistët konsiderohen miq të resortit.

"Prestige Resort" është një oaz qetësie e argëtimi. Të parët që i besuan emrit të resortit ishin miqtë e largët të vendeve nordike, turistët elitare që vijnë nga vende si Suedia, Norvegjia, Finlanda dhe Danimarka, të cilët kanë ardhur përmes agjencive turistike prestigjioze si 'Apollo' dhe 'Der Turistik' për të njohur një Shqipëri tjetër". Pushuesit nordikë kanë kuriozitet për historinë dhe natyrën e Shqipërisë. Përveç detit, ata duan të përjetojnë edhe eksperiencën të tjera në mal, duan të vizitojnë qytetet e lashta, e pse jo edhe të shijojnë pasditeve jetën e gjallë të Tiranës. Resorti krenohet me dhomat e bollshme, bashkëkohore e komode, duke u bërë një zgjedhje e shkëlqyer për pushime ideale. "Prestige Resort" në Golem është një nga resortet e rezervuara deri në vitin 2020 nga turistët nordikë.

Turistët janë ambasadorët më të mirë të vendit, që do të kthehen në vendin e tyre me mbresa më të mira nga "Hirushja" e bregdetit shqiptar edhe këtë sezon veror.

DEBATI PER TEATRIN

“Ligj haxhiqamilit”

Angjeli: Një buldozer shemb dy teatro kombëtarë, Krasta: Fillimi i rënies

Debati në Komisionin e Medias, opozita braktis seancën ku do votohej nen për nen

E djathta dhe protestuesit i drejtohen mazhorancës: Mos u bëni kamikazë

Fatmira Nikolli

Nga etiketimi ‘haxhiqamilit’ te kamikazë, ligjërimi politik në mbledhjen e djeshme të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik nuk arriti të prodhojë një lajm të mirë për teatrin.

Pritej, diskutimi nen për nen i ligjit për “Përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”.

Mbledhja nisi me dëgjësën e pesë përfaqësuesve të aktorëve e shoqërisë civile që protestojnë prej muajit shkurt për mbrojtjen e truallit e godinës së TK-së dhe kundër ndërtimit me PPP.

Gazetarja Elsa Demo, aktori Sokol Angjeli, producenti Robert Budina dhe ish-drejtori i Institutit të Monumenteve Apollon Baçe shpjeguan si grup interesi gjitha arsyet pse duhet ruajtur godina e TK.

I pari e mori fjalën Baçe duke e nisur me një vlerësim për Edi Ramën si artist, por jo si kritik arti. Mandej ai vlerësoi arkitekturën e TK-së, duke e renditur atë si të rëndësishëm në historinë e arkitekturës përkrah Bankës së Shqipërisë, Hotel “Dajtit”. “Këto pak monumente që kanë ngelur nga ajo kohë (vitet 30-40) të ruhen. Ajo që i ka dhënë fytyrë Tiranës është arkitektura italiane. Me të gjitha kullat ndërtime që janë bërë si ajo pranë Gjykatës së Lartë, mendoj se nëse ka alienë duhet të jetojnë në pallate të tilla. Mos e shembni se do shembni teatrin, se do shembni një pjesë të historisë sonë”.

Pas tij, fjalën e mori Robert Budina.

“S’kam shumë për të thënë. As argumente të reja. Në pesë muaj janë thënë shumë. Kam një thirrje të zëshur nga çdo lloj gjëje që ai të mos preket. Si intelektual nukhas që po çmontojmë veten tonë. E shoh si një vendim të pasinqertë. Kemi 5 muaj që takojmë këdo. Është e vërtetë që i keni votuar për ta kaluar, por nuk duhet ta bëni”, tha ai. Shtoi, se të gjithë duam teatër të ri, por jo aty: “Mund të ishim



Në foto: Dje në Komisionin e Medias

mbledhur dhe të kishim bërë më të mirën. Mund të kishim ofruar ndihmë për ndërtimin e një teatri të ri e rikonstruksionin e këtij që kemi”, shtoi ai.

Gazetarja Elsa Demo e cilësoi si një absurditet lumturisht të bukur këtë që po ndodh. “Kanë ardhur njerëz në shi, për të firmosur peticionin për mbrojtjen e tij. Kanë ardhur njerëz që u dridhej mjekra e zëri. Sigurisht, ai teatër ka krijuar vlera dhe ka prodhuar antivlera. Arkitektët e pavarur kanë argumentuar se ai mund të rikonstruktohet. Nuk e kuptoj pse doni ta modernizoni brenda jashtë”.

Në vijim aktori Sokol Angjeli vuri në dukje se po shembën dy teatro e jo një. “Është në një anë teatri i dramës e komedisë dhe në anën tjetër është Teatri Eksperimental. Me një buldozer po shembni dy teatro kombëtarë dhe po nuk po e thotë njeri. Ju thonë po të kishit një UEFA teatri çdo ishte bërë. PO ju them se ne ishim në një ‘Uefa teatri’ në alcencën europiane, po na nxorët nga ajo alcencë, nga nxorët nga ajo Uefa e teatrit”, tha aktori. Shtoi në fund se gjurma e teatrove sot është 8000 e ca metra katrorë, ndërsa gjurma e teatrit të ri, duke mbledhur hapësirën e katit të parë, të dytë, të tretë, e dy kateve nëndhese po të doni është 2000 metra. Ndërkohe ju thonë nuk preket asnjë cm. Nëse ju merrni sipërfaqen e 5 kateve, mbase-mbase do e bëni hapësirave e 2 teatrove.

Deputetja Jorida Tabaku tha se më 1939 Montanelli shkruante se Tirana është një qytet me të tashme e të ardhme, pa të shkuar. E njëjta gjë ndodh edhe sot. Për Tabakun, e njëjta gjë mund të

thuhet edhe sot.

Të pyetur për dëgjësën e takimit, Budina tha se prej 5 muajsh që rrinë në protestë, i është kërkuar ministres takim, por nuk ka ardhur. “Nuk erdhën në teatër, thirrën disa artistë. Ne nuk jemi grup i strukturuar. U bëmë vetvetiu një grup”.

Albana Vokshi bëri me dije se dje i është dërguar një letër drejtoreshës së UNESCO-s, kryetares së komisionit parlamentar për kulturën dhe në Këshillin e Europës i është shkruar përgjegjës për çështjen e kulturës.

Gazetarja Elsa Demo kujtoi se para se të niste çështja e teatrit, nisi ligji për artin e kulturën. “Pas qëndresës së artistëve Ministria i Kulturës u tërhoq. Një kamikaz vret veten dhe vret shumë të tjerë nga pas. Mos e vrisni veten”, tha ajo duke ju referuar çështjes së teatrit. Më pas deputetja Vali Duka e quajti ligjin për teatrin një ligj haxhiqamilit. “Është ligj haxhiqamilit. Haxhi Qamili shkoi në Berat e dogji bibliotekën. Të kujtoni atë kur të votoni ju të mazhorancës. Është për mendur në ligjërimit politik të javës së shkuar Esad Toptani. Esadi ishte i vetmi që ngatërroi privaten me publikën 100 vite më parë. Sot janë shumë”, tha ajo. Në fund, duke qenë se nga Ministria e Kulturës për të folur për ligjin, nuk ishte zministria apo ministria, deputetët e opozitës braktisën komisionin, duke refuzuar të jenë në votimin nen për nen të ligjit.

Deputetja Jorida Tabaku tha se më 1939 Montanelli shkruante se Tirana është një qytet me të tashme e të ardhme, pa të shkuar. E njëjta gjë ndodh edhe sot. Për Tabakun, e njëjta gjë mund të

thuhet edhe sot.

Të pyetur për dëgjësën e takimit, Budina tha se prej 5 muajsh që rrinë në protestë, i është kërkuar ministres takim, por nuk ka ardhur. “Nuk erdhën në teatër, thirrën disa artistë. Ne nuk jemi grup i strukturuar. U bëmë vetvetiu një grup”.

Albana Vokshi bëri me dije se dje i është dërguar një letër drejtoreshës së UNESCO-s, kryetares së komisionit parlamentar për kulturën dhe në Këshillin e Europës i është shkruar përgjegjës për çështjen e kulturës.

Gazetarja Elsa Demo kujtoi se para se të niste çështja e teatrit, nisi ligji për artin e kulturën. “Pas qëndresës së artistëve Ministria i Kulturës u tërhoq. Një kamikaz vret veten dhe vret shumë të tjerë nga pas. Mos e vrisni veten”, tha ajo duke ju referuar çështjes së teatrit. Më pas deputetja Vali Duka e quajti ligjin për teatrin një ligj haxhiqamilit. “Është ligj haxhiqamilit. Haxhi Qamili shkoi në Berat e dogji bibliotekën. Të kujtoni atë kur të votoni ju të mazhorancës. Është për mendur në ligjërimit politik të javës së shkuar Esad Toptani. Esadi ishte i vetmi që ngatërroi privaten me publikën 100 vite më parë. Sot janë shumë”, tha ajo. Në fund, duke qenë se nga Ministria e Kulturës për të folur për ligjin, nuk ishte zministria apo ministria, deputetët e opozitës braktisën komisionin, duke refuzuar të jenë në votimin nen për nen të ligjit.



Në foto: Adi Krasta

KOMISIONI NR 2

Në Komisionin për Vepërimitaritetë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka vijuar debati kundër shembjes së Teatrit Kombëtar. Veç deputetëve Klevis Balliu, Aldo Bumçi, Agron Shehaj, që folën për korrupsion në çështjet e projektit për TK-në dhe ngjritjen pyetje mbi refuzimin e restaurimit të godinës, ka folur edhe aktori Neritan Liçaj. “Nëse ndonjëri nga ju do të vinte një javë në atë teatër do të binit në dashuri me të. Nuk do të donit kurrë të iknit nga ai vend. Ju, nuk e keni idenë se çfarë dashurie e madhe është ai vend. Kam 25 vjet që shkoj aty. Si mendoni ju, që do shkoja aty, të rrezikoja jetën time, kokën time dhe të ardhmen e dy fëmijëve të mi duke shkuar aty? Të jeni të bidnuri, është shumë i sigurt. Ju jenideputet të popullit, më shikoni në sy, nuk vritet nëna sepse është plakur. Çdonjëri prej nesh, do shkointe të merrte kredi, ta çonte në spital që t’ia zgjaste jetën”, tha Liçaj.

PROTESTA

Nërsa ligji kaloi vetëm me votat e mazhorancës në rendin e ditës për seancën plenare të së enjtes, në mbrëmje, protesta vazhdoi. E nisi Robert Budina. “Sot isha në komision. Deputetët janë kthyer në numra dhe në sytë e tyre e lexonim që e dinin që janë numra. Ata përgjigjen e morën dje. Pak njerëz qenë në inaugurimin e teatrit ku kryeministri u bë kritik arti. Besoni të vetja juaj, se jam i bindur do e kenë të vështirë. Nëse e miratojnë, do vëmë shfaqje këtu. Do vëmë Arturo Ui-në”, tha ai. Më pas fjalën e mori aktorja Klodiana Keço, që tha se e sheh situatën si pritje në reanimacion. “Sa për cilësinë, nuk e kemi fajin ne që aktorët në këtë godinë janë të shitur: Shohim që miratohen projekte të cilave nuk u lexohet përmbajtja”. Në një shesh plot, foli edhe poeti Primo Shllaku në

mbrojtje të godinës, vëllai i të cilit, aktori Bruno Shllaku pjesë e strukturave të PS, ka kërkuar shembjen e saj. Po dje, pas një qëndrimi në “Facebook”, në sheshin mes dy teatrove kombëtarë që rrezikojnë shembjen, erdhi Adi Krasta. “Nuk jam aktor po do kisha qenë i dobët. E megjithatë, kam intervistuar shumë aktorë në këta 30 vjet dhe kam kuptuar se sa e rëndësishme ka qenë çdo gjë për ta, çdo detaj, gjërat e vogla”. Për Krastën, më e pakta është e pasinqertë drama për të shpëtuar teatrin nga ana qeveritare. “Maksimalisht është shumë e dyshimtë. Do të thotë të jesh i palexuar për vlerat e tij, të mos kesh lexuar Aurel Plasarin e të mos shohësh njerëz si ju që rrinë këtu pa asnjë interes”, tha ai. Shtoi se po ra kompleksi Teatror “Skanderbeg” e këtu të ndërtohen kulla, nëse do ndërtohen kulla te Galeria e te Muzeu, kjo do të bëjë që Tiranën të mos e njohim më. “Është qytet ku ha het bukë, filhet gjumë e nuk ndodh asgjë tjetër. Në rastin më të keq marrëzia e rrëzon këtë vend (teatrin). Por mendoj se marrëzia do jetë fillimi i rënies së madhe. Nuk ka injorancë e arrogancë të pandëshkueshme. Duhet t’i thonë këshilltarët kryeministrit se të tërhiqesh është burrëri. Ngulmimi duke folur bu-dallallëqe pa fund, obsesioni tregon një deviacion psikologjik. I pakënaqur nga çdo gjë. Kaq kuptoj unë. Jo, rroftë kompleksi Skandëberg të qëndrojë ekzakzësist këshu”, tha Krasta. Po dje, 77 arkitektë, urbanistë, konstruktorë i thanë ‘Jo’ shembjes së Teatrit Kombëtar dhe kështu Teatrit Kombëtar Eksperimental. Ata i kanë dërguar një letër të hapur presidentit Ilir Meta, kryeministrit Edi Rama, kryetarit të Kuvendit Gramoz Ruci dhe kreut të Bashkisë Tiranë Erion Veliaj, ku dalin kundër shembjes.

Dje në "Reporter.al"

Sundimi me ligje speciale është e kundërta e sundimit të ligjit

Nga Gjergj Erebara

(Vijon nga faqja 1)

... "sundim ligji". Pavarësisht se e kemi dëgjuar shumë herë, duket se ne shqiptarët nuk e kemi brenësuar mirë këtë koncept. Para së gjithash se ai bën ndesh me traditën tonë, të mishëruar jo vetëm në historinë e trazuar të vendit, por edhe në shprehje popullore të llojit "unë bëj ligjin", "ai bën ligjin" apo "fjala e tij është ligj", të tria shprehje për të shpjeguar një figurë autoritare, i cili mund të na urdhërojë dhe ne duhet të bindemi, sepse "ai është vetë ligji".

Kjo në vetvete është e kundërta e sundimit të ligjit, atij konceptit evropian, që ne duhet të mësojmë mirë si pjesë e rrugëtimit tonë në Bashkimin Evropian. Nëse kërkojmë në "Google" me termin "sundim i ligjit", marrim një seri përgjigjesh që sillen rreth këtij koncepti: "Kufizimi i ushtrimit arbitrar të pushtetit, duke ua nënshtruar pushtetin ligjeve të mirëpërcaktuara dhe ekzistuese".

Chris Patten, ish-gubernatori i fundit i Hong Kongut, u përpoq ta shpjegojë me mirë këtë koncept në kontekstin e Kinës moderne, ku si në Shqipëri, qeveria jo thjesht u nënshtrohet ligjeve, ajo i bën ligjet si të dojë.

Thotë Patten: "Qeveritë autoritare duket se e kanë të vështirë ta kuptojnë këtë koncept. Unë mbaj mend negociatat me homologun tim kinez kur isha guvernator i Hong Kongut. Unë po përiqesha t'i shpjegoja se pse sundimi i ligjit kishte kaq shumë rëndësi për të ardhmen e këtij territori dhe vërejtja se kur isha në qeverinë e Britanisë, ligji zbatohet mbi mua po aq sa mbi ata për të cilët unë ndihmoja të qeveriseshin. Bashkëbiseduesi im mendoi se po bëja shaka. Në praktikën kineze kjo është sundim përmes ligjit – ligjit të hartuar nga Partia Komuniste për interes të vet".

Në vitin 2015, një kompani shtetërore kineze erdhi në Shqipëri dhe u interesua për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Nuk dihet se si ndodhi, por kjo kompani kineze nuk u nënshtrua ligjeve ekzistuese të vendit. Ajo mori një ligj të vetin, ligjin 41/2015. "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociatën dhe lidhjen e kontratës koncesionare/PPP, me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit, ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë "China State Construction Company".

Parlamenti shqiptar, i cili nuk është tamam parlament, pasi funksionon thjesht si një noter i kryeministrit të radhës, e miratoi këtë "ligj të veçantë" pa e vrarë mendjen shumë. Ne të tjerët nuk



arritëm të vinim re se çfarë po ndodhte. Në fund të fundit, Rruga e Arbrit është një nevojë për zonën e Dibrës dhe këtu qëllimi rezultoi më i rëndësishëm se sa mjeti. Por përmes një ligji të tillë, kinezët dhe qeveria shqiptare bënë tri gjëra: e para, anashkaluan kuadrin ligjor ekzistues, i cili kërkon që nëse shteti dëshiron të bëjë ndonjë punë, duhet që t'u nënshtrohet ligjeve dhe jo "të bëjë ligjin". E dyta, me një ligj të veçantë, qeveria i dha të drejtë vetes të bëjë pazar me interesat ekonomike të taksapaguesve pa i dhënë kurrfarë llogarie këtyre të fundit. E treta, ligji në fjalë i

lejoi qeverisë që fillimisht të negocionte me kinezët jashtë çdo lloj kuadri ligjor dhe pasi të arrinte çfarë të pëlqente, ta çonte rezultatin e negociatave për miratim në Kuvend përmes "procedurës së veçantë të negociatimit". Me një veprim të thjeshtë, qeveria shqiptare kopjoi praktikën e Partisë Komuniste të Kinës, e cila si forcë diktatoriale që është, bën çfarë të dojë me ligjet e vendit.

Ligji "Për rrugën e Arbrit" dështoi. Marrëveshja nuk u miratua kurrë, sepse bisedimet nuk u mbyllën kurrë. Megjithatë, precedenti i vendosur me këtë "procedurë të

veçantë negociimi" i shërbeu Ramës edhe për tri kontrata të tilla.

Dy nga këto tri kontrata mund të interpretoheshin si tepër të mëdha, ose tepër të rëndësishme për t'u trajtuar me ligjet ekzistuese. E dyta ishte "negocimi për Portin e Karpenit", një ide fantazmagorike që kushtoi disa qindra mijëra dollarë shpenzime "konsulente" për të mos sjellë asgjë, por që premtonte investime në masën 5 miliardë dollarë. E treta ishte kontrata për ndërtimin e Aeroportit të Vlorës, e cila është ende në "negocim". Sërish, ne e anashkaluam peshën e "sundimit përmes ligjit".

Tani qeveria ka paraqitur një kontratë të katërt. Ajo për Teatrin Kombëtar. Jo vetëm që kontrata përbën "sundim përmes ligjit", por ajo përbën edhe një nivel të ri banaliteti. Nuk bëhet më fjalë për rrugë me tunele, porte fantazmagorike apo aeroporte. Bëhet fjalë për një pronë publike rreth 8500 metra katrorë që duhet t'i jepet një kompanie vendëse për të ndërtuar pallate.

Në përputhje të plotë me praktikën e sundimit përmes ligjit, de-

putetët socialistë ia dhanë votën procedurës së përsheptuar për trajtimin e projektligjit dhe pritët t'ia japin votën projektligjit në tërësi tani shpejt, pa kurrfarë brerjeje ndërgjegjeje. Figurat më të ndritura socialiste, përfshirë ish-kryeministrin Pandeli Majko, nuk u menduan dy herë. As nuk debatuan, as nuk ngritën pyetje për qeverinë "Rama". Më shumë se sa ligjëvënës, të gjithë deputetët në të majtë e në të djathtë janë shërbyes të kryetarit. Vendi efektivisht nuk ka një parlament dhe ky është rezultat i marrëveshjes Berisha-Rama të vitit 2008.

Shqipëria ka precedent të hidhur mbi sundimin e kryeministrit përmes dekret-ligjeve. Dhe përveç precedentëve, ka edhe telashin se u ka mësuar fëmijëve nëpër shkolla përralla me Skënderbeu dhe jo leksione mbi sistemet kushtetuese.

Në kohën e komunizmit, zinxhiri sundues i vendit përbëhej nga të ashtuquajturat dekret-ligje, të cilat i firmoste Presidiumi i Kuvendit Popullor (organ kolegjial ekuivalent i Presidentit të Republikës). Dekret-ligjet hynin në fuqi menjëherë, ndërsa parlamenti mblidhej "dy herë në vit" për t'i miratuar ato. Në fakt, parlamenti mblidhej dy herë në vit thjesht për të duartkrokatur dekretligjet e miratuara.

Dhe në lidhje me funksionet e parlamentit, edhe kryeministri i sotëm Edi Rama nuk e ka fshehur dëshirën që parlamenti të mos mblidhet një herë në javë, siç mblidhet aktualisht, por mundësisht të mblidhet një herë në muaj. Në janar të këtij viti, Taulant Balla, kryetar i grupit parlamentar socialist dhe një nga ata që votoi ligjin "për procedurë të veçantë negociimi" për Teatrin Kombëtar, propozoi ndryshime në rregulloren e Kuvendit dhe mes të tjerash, kërkoi që Kuvendi të mblidhet më rrallë, mundësisht një herë në muaj. Në këtë rast, qeveria do ta ketë më të lehtë që të bëjë çfarë të dojë me taksat dhe me pronën publike dhe më pas t'ua dërgojë rrobat e veta të palara deputetëve të vet të përlulur për t'i duartkrokatur si arrijetë historike.

Por, më shqetësuesja nga të gjitha duhet të jetë fakti se projektligji aktual për teatrin argumentohet në relacion si një dokument që "ka precedent", d.m.th., që qeveria ka në plan ta bëjë rrugë sundimin përmes ligjeve të veçantë.

Përveç faktit që projektligje të tilla duhet të jenë fakti të konsiderohen antikushtetuese, ato formalizojnë në ligj një Shqipëri tashmë të ndarë më dysh. Një palë ligje që miratohen për elitën dhe klientelën e saj politike. Dhe një palë ligjesh të tjera për ne të gjithë të tjerët. Papritur ne do ta gjejmë veten qytetarë të dorës së dytë.

Opinion *i* Ditës

Diplomat e ‘Luarasi’, një pasaportë e fortë punësimi

Nga Dorina Gjipali

(vijon nga faqja 1)

... moshën e re të gjimnazistëve dhe informacionin e pamjaftueshëm që shpesh herë kanë në dispozicion. Pyetjet që shoqërojnë këta të rinj gjatë zgjedhjes së universitetit janë të shumta: Të studioj në Shqipëri apo të studioj jashtë Shqipërisë? Të zgjedh një universitet publik apo një universitet privat? Të ndjek këshillën e prindërve apo këshillën e miqve e shokëve tashmë të diplomuar? Të zgjedh profesionin e ëndërruar, traditën familjare apo profesionin që i përshatet tregut të punës? A do të më japë diploma akses në tregun e punës pas përfundimit të studimeve?

Këto janë vetëm disa nga pyetjet që bashkojnë sot mijëra gjimnazistë, të cilët po vlerësojnë me kujdes programet e studimit që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë, në mënyrë që të arrijnë të marrin vendimin e duhur.

Do të ishte i mjaftueshëm emri dhe tradita 15 vjeçare e Universitetit ‘Luarasi’ që ai të ishte zgjedhja e qindra maturantëve për të vazhduar studimet. Por krahas kësaj, që në krijimin e tij Universiteti ‘Luarasi’, përtej misionit që ka çdo institucion i arsimit të lartë për të përcjellë dije dhe formim cilësor, mori përsipër përgjegjësinë të ishte qendër profesionalizmi, të nxirrte profesionistë që të mund t’i përgjigjesin sfidave dhe kërkesave të tregut të punës.

Ky institucion, vit pas viti është kujdesur dhe kujdeset që të diplomuarit e tij të mos marrin vetëm një diplomë, por gjatë viteve të studimit, të fitojnë aftësitë, ekspertizën dhe kompetencat e duhura për tregun e punës.

Luarasi, është shembulli më i mirë ku universiteti krijon lidhje direkte midis studentit dhe biznesit, gjatë dhe pas mbarimit të studimeve universitare. Fakt për t’u përmendur është punësimi i shumë prej studentëve të diplomuar në Universitetin ‘Luarasi’ në një nga Grupet investitore më të rëndësishëm në Shqipëri, Hysenbelliu Group. Për më tepër, praktikat mesimor, trajnimet, intershipet marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe programet dhe projektet e ‘Luarasi’ janë të gjitha në funksion të aftësimin të studentit dhe krijimit të profesionistëve ende pa përfunduar studimet universitare. Ky institucion beson fort se vetëm bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe konkret midis universitetit dhe biznesit mund të ofrojë kapitalin njerëzor më të mirë për tregun e punës.

Për çdo punëdhënës diploma e marrë në një institucion prestigjioz është parakusht për një intervistë pune, por i diplomuari duhet,



mbi të gjitha, të jetë i përgatitur që me njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë shkollimit, të arrijë të përmbushë synimet e punëdhënësit. Sfidat me të cilën përballën sot institucionet e arsimit të lartë është ofrimi i një produkti (diplome) sa më konkurruese në dije dhe aftësi për tregun e punës. Kjo, sepse tregu i punës vlerëson më të aftin dhe Diploma e ‘Luarasi’ është

treguesi më i mirë për këtë. Shumica e të diplomuarve të ‘Luarasi’ gjejnë punë menjëherë pas përfundimit të studimeve. Ata ushtrojnë profesionet e tyre me shumë kompetencë kudo ku punojnë, në institucione publike e private. Kjo mendohet se është arritja më e rëndësishme për një universitet. Arritjet tjetër e rëndësishme e Luarasi është numri i madh i studentëve që kanë vijuar studimet e ciklit të dytë

në universitet më të mira perëndimore duke ndërkombëtarizuar më së miri Diplomën e ‘Luarasi’.

Nuk duhet domosdoshmërisht të studiosh jashtë që të punësohesh dhe të paguhesh mirë. Të tre fakultetet e ‘Luarasi’, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ofrojnë programet e studimit më të kërkuara sot në tregun global dhe padyshim profesionet që kërkojnë dhe paguhen më shumë.

Të zgjedhësh universitetin do të thotë të fillosh të ndërtosh të ardhmen tënde: për këtë arsye zgjedhja duhet të jetë e mirë menduar. Duhet zgjedhur me patjetër programi i studimit i preferuar, por duhet menduar dhe perspektiva e punësimit që na ofron ky program. Të zgjedhësh Diplomën e ‘Luarasi’ sot, do të thotë të zgjedhësh pasaportën që do të paraqesësh në tregun e punës nesër.

Do të ishte i mjaftueshëm emri dhe tradita 15 vjeçare e Universitetit ‘Luarasi’ që ai të ishte zgjedhja e qindra maturantëve për të vazhduar studimet. Por krahas kësaj, që në krijimin e tij Universiteti ‘Luarasi’, përtej misionit që ka çdo institucion i arsimit të lartë për të përcjellë dije dhe formim cilësor, mori përsipër përgjegjësinë të ishte qendër profesionalizmi, të nxirrte profesionistë që të mund t’i përgjigjesin sfidave dhe kërkesave të tregut të punës.

HOROSKOPI

DASHI

Krijoni miqësi edhe kur gjendeni para opinionëve dhe pozicioneve të ndryshme. Bashkëveprimi i Jupiterit me Saturnin do t’ju ndihmojë të zgjeroni rrethin e njohjeve tuaja. Në shumëllojshmërinë natyrale do të zbuloni një tërësi që do të arrijë t’ju pasurojë shumë.

DEMI

Përpikuni të vendosni rregull në jetën tuaj, si në nivelin fizik ashtu edhe në atë mendor, nëse nuk dëshironi të krijoni konfuzion, gjë që nuk ju pëlqen aspak. Përdorni kohën e lirë që do të keni në dispozicion për të organizuar më mirë hapësirën, ndoshta duke ndryshuar diçka.

BINJAKET

Mos lejoni asgjë dhe asnjëri që t’ju shkatërrojë planet tuaja, edhe pse e keni planifikuar programin e të ditës me shumë kujdes. Çdo detaj është i rëndësishëm dhe ju nuk ja keni lënë asgjë rastësisë. Gjë që është merita tuaj, sigurisht.

GAFORJA

Do të arrini më në fund të hidhni pas kraheve një çështje të së kaluarës që ju pengon të shihni përpara, sidomos në jetën private. Do të ndjeheni shumë më mirë. Nuk jeni më të gatshëm të toleroni gjëra që nuk ju pëlqejnë dhe të tjerët do ta kuptojnë vendosmërinë tuaj.

LUANI

Në këtë periudhë mund të jepni maksimumin në sportin tuaj të preferuar. Aktiviteti fizik i moderuar është shumë i shëndetshëm: jeni shumë mirë. Do të keni një ditë të gëzueshme dhe kohë e lirë e çmuar, për t’ia përkushtuar të tjerëve, por sigurisht edhe pak vetes.

VIRGJERESHA

Nganjehëre nuk dini si të menaxhoni një lloj tendence që keni për t’u dekurajuar shpejt. I ktheheni mendimeve negative që nuk kanë arsye të ekzistojnë. Përfitoni nga kjo ditë e qetë që të qetësoheni disa nga të gjithë gjërat që ju rëndojnë pak.

PESHORJA

Gjatë ditës së sotme të tjerët do t’ju ndihmojnë në punët e shtëpisë, kështu që do arrini të keni pak kohë të lirë për vetel. Jeni gjithmonë të gatshëm të ndihmoni të tjerët dhe asnjëri nuk do refuzojë t’ju japë një ndihmë të vogël, nëse ja kërkonin ju.

AKREPI

Një çështje pune rrezikon t’ju prishë disa ditën. Nëse nuk është aq urgjente, tregohuni të vendosur që ta mbani jashtë portës. Do ta zgjidhni nesër. Momente të këndshme të kaluara në familje dhe me miq do t’ju kthejnë humorin e mirë.

SHIGJETARI

Dita e sotme do të jetë një ditë e përkryer për të kaluar kohë me të afërmit tuaj dhe miqtë. Nuk ka rëndësi nëse e kaloni në shtëpi apo jashtë. A do të ketë vendime të rëndësishme për t’u marrë? Me bënensin tuaj, nuk do të lini t’ju shpëtojë asnjë detaj.

BRICJAPI

Plutoni që nuk ju favorizon mund t’ju shkaktojë të bëni reagime të papritura e të tepruara, edhe për motive banale dhe me pak rëndësi. Shkarkoni tensionin e krijuar duke u marrë me pak sport. Lodhja në nivel fizik do ju qetësojë në profilin mendor.

UJORI

Bashkëveprimi i Saturnit, Uranit dhe Plutoni që ju mbështesin, do t’ju dhurojnë një ditë të paharueshme, në të gjitha aspektet! Është e sigurt që nuk do të merrziteni dhe do jeni gjithmonë në mes të aktiviteteve interesante dhe personave intrigues.

PESHQIT

Duke qenë se duhet të analizoni një situatë, duhet të merrni parasysh më shumë se një aspekt, nëse nuk doni të humbini një gjë shumë të rëndësishme. Keni aftësi të shkëlqyera, por që nganjëherë mbeten në hije nga nxitimi juaj për të përfunduar çdo gjë.

Situatë e pabesueshme deri në idiotësi

Bëri gjestin e "shqiponjës", Larisa anulon kontratën me Bathën

Gjatë ditës së djeshme është bërë publike arsyeja që ka bërë të dështojë transferimi i Idriz Bathës drejt klubit të AEL-it. Një arsye sa qesharake, aq edhe e turpshme. Një histori mashtrimi dhe ksenofobie nga ana e klubit grek, që një nga shkaqet e anulimit të kontratës së Bathës ka



qenë fotoja e tij me gjestin e "shqiponjës" në kohën kur luante te Partizani. Ja edhe mesazhi i që i ka sjellë klubi grek agentit rumun të Idriz Bathës. "Në krye të radhës duhet të

them se ti ke bërë një gabim të madh për të anuluar këtë marrëveshje, pasi na the se lojtari kishte shumë oferta, për shembull nga Astra ku lojtari i ofrohej 8.000 euro. Gjith-

ashtu na the se fiton 6.000 euro në vit në skuadrën e tij, ndërsa ai merr vetëm 4.000 euro. Pas kësaj, arsyeja e vërtetë që ne e anuluar këtë marrëveshje është fakti se kemi parë një

foto të futbollistit në internet, ku ai feston me simbolin e Shqipërisë së Madhe. Kjo është vërtetë një gjë e keqe, pasi në skuadrë ne kemi shumë serbë, ndërsa Shqipëria e Madhe përfshin disa pjesë të Maqedonisë, Greqisë dhe kjo do të dështëponte tifozët e klubit", ka thënë Vasilis Vanis, drejtori sportiv i AEL-it.

Jeton Selimi



Europa shkon në turin tjetër me 6 skuadra të kualifikuara. 2 do të jenë nga Amerika Latine

Suedia habit Zvicrën, Anglia kalon Kolumbinë

Dy skuadrat do ndeshen mes tyre në çerekfinale

Kolumbi-Angli pritej me shumë kërshtëri, pasi veç ndeshjes Francë-Argjentinë, kjo cilësohej si një nga sfidat më premtuese. Dhe ashtu rezultoi të ishte. Rastin e parë të rrezikshëm e krijojnë ishullorët, kur Tripiër harkon për kokën e Kejn dhe shtatlatr-tii Totenhemit devijon, por veç pak sipër traut. Kolumbia përpiqet disi, por nuk kërcënon siç duhet, ndërsa Anglia duket më mirë e vendosur: Loja është e fortë dhe fizike, madje gjakrat nxehen shpesh, ndërsa gjyqtari amerikan Mark Geiger ka jo pak punë. Triper nga goditja e dënimit kalon murin, por nuk gjen portën, ndërsa guajtja e Kinteros është shumë e brishtë për të shqetësuar Pikfordin. Pjesa e parë mbyllet me rrjeta të paprekura, ndërsa në të dytën dozat e emocioneve do të jenë më të forta.

Minuta e 54-të dhe Sançez rrëzon Kejnin në zonë dhe për Geiger kemi 11-metërsh, të cilin e konfirmon edhe VAR-i. Nga pika e bardhë paraqitet vetë Kejn, që ekezkuton saktësisht duke shënuar golin e tij të gjashtë në këtë Kupë Botë. Në minutën e 62-të Kolumbia shpërthen ndaj simulimit të Meguarjër të Greiger e gëton me kartonë vrellin e Falkaos me shokë. Ndeshja futet në momente emocionuese. Kolumbia kërkon me forcë barazimin dhe do të kërkohet të shënojë, ndërsa i shkon shumë pranë me Kuadraron, që me të djathtën gjuan shumë keq



duke mos gjetur kuadratin e portës. Falkao do të përpiqet vetë në dy momente, por goditjet e tij nuk e shqetësojnë Pikfordin. Në kohën shtesë "loskafeteros" duket se janë të pashpresë, por Uribe nga distanca e largët detyron Pikfordin të grushtojë në këndore dhe nga

ajo këndore i zakonshmi Mina me kokë nuk fal duke barazuar për Kolumbinë në frymën e fundit. Pavarësisht se dëshira nuk mungon, gola nuk do të ketë dhe për herë të tretë në këto çerekfinale, skuadrat do të drejtohen penaltive. Falkao, Kuadrado dhe Muriel ekeku-

tojnë saktë për kolumbianët, ndërsa te anglezët pas Kejn dhe Rashford që shënojnë, gabon Henderson. Gjithsesi ishullorët e barazojnë serinë, pasi Uribe e gabon penalltinë e tij, ndërsa Triper shënon. Vendimtare seritë e pesta. Baka para Pikfordit gjuan fort, por grushton portieri i Evertonit. Për Anglinë ka në dorë penalltinë kualifikuese Dajjer, që përballë Ospinës gjuan saktë, duke bërë me krahë "Tre luanët" që fluturojnë në çerekfinale, skuadra e gjashtë evropiane që arrin në këtë fazë, ndërsa Kolumbia fatkeqësisht kthehet në shtëpi, pavarësisht emocioneve të shumta që ka dhuruar në këtë Botëror.

SUEDIA

Suedia trondit Zvicrën! Nordikët fitojnë betejën me helvetët dhe fluturojnë në çerekfinale. Kësaj radhe shqiptarët nuk mundën dot të bënin asgjë për të ndihmuar Vladimir Petkoviç dhe pjesën tjetër të ekipit. Ndërshja nga parashikimet, "kryqetarët" vuajtën shumë përballë verdhebluve.

Madje, përjashtu minutat e fundit të ndeshjes, pjesën tjetër të 90-minutëshit e kontrolluan të besuarit e Jane Andersonit. Suedia e nis më mirë takimin dhe kërkon të ngacmojë Somerin, por Berg gjuan keq me të jashtëm. Zvicra nuk arrin t'u marrë metra suedezëve dhe dështon vazhdimisht me krosimet nga krahët. Rodrigez dhe Shaqiri përplasen gjithmonë te muri i shtatlatrëve nordikë. Në momentin e vetëm që topi fluturon në zonë, Xhemajli e fluturon në tribunë, ndërsa Xhaka pronon me kot me guajtje nga jashtë. Suedia mund të kishte shënuar me Albin Edkal, që kishte të gjithë kohën e nevojshme në dispozicion, por mesfushori nxitohet dhe godet jashtë. Pjesa e parë do të mbyllet pa gola, ndërsa edhe e dyta do të jetë një fotokopje e së parës. Lojë kryesisht në mesfushë, Zvicra që rreket me kot të çajë nga krahët, ndërsa suedezët që gabojnë gjithçka në metrat e fundit. Por goli do të vijë. Minuta e 66-të, Emil

Forsberg gjuan me të djathtën dhe topi devijohet nga Akanjiri dhe nxjer jashtë lojë portierin Zomer, që sheh topin të prehet në rrjetë. Suedia shënon dhe Zvicra zgjohet. Helvetët do të përpiqen të baraspeshojnë gjithçka, por garthi i gjigantëve të akullit para tyre është thjesht e pakalueshëm, madje edhe atëherë kur duket se topi do të shkojë në rrjetë, do dalë dikush që ta largojë përpara se të kalojë vijën fatale. Harkime pa fund nga krahët, topa të gjatë pas shpine të mbrotjtës, asgjë nuk bën efekt, Suedia ka mbyllur hapërsirat, ndërsa në sekondat e fundit do të ishin pikërisht nordikët ata që mund të shënonin, por fillimisht penalltimin e vërshtellur nga Skomina u ktheje në goditje dënimi në hyrje të zonës, ndërsa më pas Zomer grushton guajtjen me gjyqtarin sloven, që vërshtellen dhe dërgon zvicranë në shtëpi. Suedia është kështu çerekfinalistja e shtatë e Botërorit.

Mesfushori vazhdon me Zvicrën

13 vite me helvetët, por Behrami nuk heq dorë



Valon Behrami ka ven dosur që të vazhdojë të jetë pjesë e përfaqësueses së Zvicrës. Futbollisti i cili ka thyer rekordin në këtë vit, duke luajtur në Botërorin e katërt radhazi në karrierën e tij, mendohej se do t'i jepte lamtumirën përfaqësueses së Zvicrës pas 13 viteve pjesë e saj. Por menjëherë pas ndeshjes kundër Suedisë, ku Zvicra u eliminua përsëri në fazën 1/8-ave, Behrami tregoi se kishte ndryshuar mendje dhe nuk e mendonte largimin, përkundrazi, ai kishte bindjen se mund të ishte protagonist në Europianin pas dy viteve. "Si sportist jam shumë i zhgënjyer nga eliminimi,

por vazhdoj të jem krenar. Dal nga ky Botëror me kokën lart. Suedezët na kanë treguar se kemi limitet tona. Por këtë unë e interpretoj si një objektiv të ri

për t'u arritur. A do largohem? Jo, unë dua të vazhdoj. Unë kam ende motivim të madh në mendjen time, shpresoj që kështu të jetë edhe fizikisht. Pse ndryshova mendje? Gjatë ditëve të fundit u ndjeva mirë këtu në ekip. Ndjeh se mund t'i jap përsëri kësaj skuadre. Dështimet në Botëror? Tani jam bërë si tip eksperti...", tha duke qeshur mesfushori shqiptar që luan për Zvicrën, ku dje mbante shiritin e kapitenit.

Japonia, dinjitet edhe në humbje


Pastrojnë stadiumin, dhomat e zhveshjes dhe thonë "faleminderit"

Ndonjëherë fiton me shumë në humbje sesa cilido sukses i ëndërruar. Japonia e provoi këtë në Botërorin e Rusisë. Djemtë e Akira Nishinos dhuruan një performancë shumë të mirë në këtë Kupë Botë. E mbyllën grupin si forcë e dytë, duke lënë pas shpine Senegalin dhe Poloninë, ndërsa më pas u përballën me Belgjikën. Një ndeshje të cilën e shijojmë të gjithë, një ndeshje nga ato që të mbeten gjatë në kujtesë. Akira Nishino mbase do t'u tregojë nipërve përallta të bukura kur të kthehet në Saifama. Ai i përket një brezit futbollistësh të rritur nën hijen e dominimit të bejsbollit, sportit më popullore në ishujt niponikë. Në fillim të viteve '80-të bota u njohe me një prej filmave të animuar më të famshëm "Kapiten Kubasa", ose i njohur për shqiptarët dhe të

gjithë banorëve të këtij planeti si "Oli dhe Benxhi", arritja e të cilëve në film, thuhet u mishërua në "Rostov Arena". Tifozët e Japonisë i kishin dedikuar skuadrës së tyre një koreografi, "Olin" kampion bote, një mesazh i qartë për "samurajët blu" të Nishinos, një dëshmi e qartë se ata, banorët e tokës për ku lind dielli besonin. Mbase jo dhe aq në fund të pjesës së parë, por me fillimin e së dytës, natyrisht që po. Madje jo vetëm ata, edhe kundërshtarët e besuan se Japonia do t'ia dilte, por fati dhe aftësitë e mëdha të Belgjikës thanë ndryshe. E ndryshuan his-

torinë në 30 minuta. Bënë që ajo koreografi e fillimit të duhej prapë ajo përallta që do të mbetet sërish legjendë, edhe pse për një moment, kur shkoi ndeshja 2-0 menduan seriozisht se Oliver Haton ishte mishëruar te Genki Haraguchi dhe Mark Lenders te Takashi Inui. Tifozët japonezë mbetën zemërtthyer në stadium. Por ata edhe mes hidhërimit nuk mund të linin shpine pas kulturën e civilizimit mijëvjeçar. T'i shije të bënin kujdes duke pastruar stadiumin në çdo sektor të tyrin ishte mbresëlënëse. Ata në tokën ku lind dielli, nuk mund të bëjnë ndryshe!

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Bëjnë arte me re.
- Krijoi Arsene Lupin (inic).
- Janë forma.
- Në hyrje të plazhit.
- Kapen të parat.
- Janë ufot.
- Mbahen nga ata që i thejnë.
- Inicialet e Mascagni-t.
- Në krye të trupave.
- Është edhe ai i Këngëve dhe valleve.
- Pak hemorragji.
- U shkrua nga Jack London.
- Institucione Ndërkombëtare Europiane.
- Scarlet e Bashkë me erën.
- Janë tituj në ekran.
- Eric aktor.
- Kështu e ka syrin vigjilent
- Janë nofka.
- Një provë... intelligence.

- Mund të jenë me sahat.
- Një pjesë e naivitetit.
- Pak imagjinatë.
- Pikat pa kufij.
- Fillojnë aksionin.
- Kërkohej nga poetët.
- Nota e diapazonit.
- I prim kolonës.
- Është filozofie moralit.
- Ulet në dhomën e lartë.

VERTIKAL

- Malet pa kufij.
- Janë banorë imagjinare të planetit të kuq.
- Inicialet e Altman.
- Një sportist që arrin majat
- Courier ish-kampion i tenisit.
- Fillojnë testin.
- Mund të jetë parabolike.
- Bie me ballë.
- Camera, ish-kampion i ringut.
- Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
- I kanë rrënjët në tokë.
- Është pushkë.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Takim Brezash Durrës.
- Ishte lumi i Elizit
- Është kardinal.
- Mbyllin një krah.
- Artikull anglez.
- Mbyllin fushat.
- Partia pa ara.
- Zola që shkroi Nana
- Nganjëherë duhen vënë mbii.
- Një fjalë kastile
- Inicialet e Mann shkrimtar.
- Maiden që këndojnë.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Fillojnë arsyetimin.
- Është nënë e Tironës.
- Është shahu i fundit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Dy asa.
- Mbarojnë fare

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL:

- Patricia këngëtare.
- I vocërr ai i Migjenit
- Hari spiune.
- Qyteti i Robespierre.
- Phineas i famshëm i cirkut.
- Nota e diapazonit.
- Pak latinisht.
- Inicilet e Banderas.
- Janë tek në rrota.
- Pak efikasitet.
- Është shkolla fillore.
- Arrihet duke aderuar
- Një... art i Don Judd.
- U kompozua nga Rachmaninov.
- Diku në qendër.
- Një është për të lidhur.
- Jepet për hartim.
- Sergej, poet i famshëm rus.


- Vëriu pa kufij.
- Mbyllin një tender.
- Një pjesë analogjisë.
- Mjeku pa ju.
- Nisin nga kreu.
- Një racë kombi.
- Pak latinisht.
- Një rapper i famshëm.
- Një pikë... vaji.
- Në fund majtas.
- Ndizen me një çelës.
- Emri i Delon
- Janë të dërguar specialë

VERETIKAL


- Është edhe ai i sheqerit.
- Është lojë papagalli.
- Një Pop i Andy Warhol.
- Sapo fillojnë.
- Qendër në Kubë.
- Është pluhuri si Dash.
- Është e hollë dhe therëse.
- Fillojnë muzikën.
- Një kontinent i ri.
- Është për medaljen e parë.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj per-sëve.
- Provinca e boerëve.
- Është qyteti i njëmbjnjë dritareve.
- Është dukuria.
- Është hidrokarbur.
- Grifitit aktore.
- Qe perëndësia e fitores.
- Mbeten në fund.
- Tregon çmimin.
- Këndohet në opera.
- Para Fe në New Mexico.
- Është princ arab.
- Tony që këndon Quando, quando, quando.
- Bën mëza.
- Pak tolerante.
- Modem pa zë.
- Pak marramendëse.
- Mbyllin një dyqan.
- Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6			9	4	
		2		7 3	
4		6		1 2	
		8		1	4
	3 8				6
4 6		3		9 7	
		2 4			
9			7	2 1	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	4	8	2	7	1	3	9	6
9	7	6	5	8	3	4	1	2
1	2	3	4	9	6	5	7	8
8	3	4	9	1	5	6	2	7
2	5	9	6	3	7	8	4	1
6	1	7	8	4	2	9	3	5
3	8	5	7	2	9	1	6	4
7	6	1	3	5	4	2	8	9
4	9	2	1	6	8	7	5	3

Argëtim filozofik

- Garat politike në 25 vitet e fundit kishin të bënin me shpërndarjen e barabartë të vezëve të arta. Në dekadat e ardhshme ne duhet të përqendrohemi në shëndetin e patave.

- Premtimi i dhënë ishte një domosdoshmëri e së kaluarës. Arsyeja se pse nuk është mbajtur, është një domosdoshmëri e së tashmes.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19	S	U	L	M	S	M	M	A	S	A	T
6	4	1	3		11				3	T	R	U	A	R	B	E	E	M	L	I	M	A
13		4		3	2	4	3	2	4	5	3		K	D	E	L	E	G	A	T	E	T
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3		18		M	I	T	O	M	A	N	E	T	D
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3		14	4		K	O	M	U	N	I	T	E	T
19			3	2	16	1	4		2	3	2			O	P	E	R	A	T	O	R	E
7	4	6	14	5						1	11	5			N	I	E	N	O	G	A	
8	11	1		6	11	14		4	2	18	11			P	S	N	N	I	M	A	L	L
3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2			A	M	I	A	N	T	K	O	S
18	8		4		5	7	6	14	6		3	5			N	O	T	E	K	I	P	O
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	5	3			I	T	N	E	T	I	L	E
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3	6			K	R	I	M	I	S	I	R

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik

Thënie të mençura

- Nëse zoti është me ju, nuk ka rëndësi se
- kush është kundra jush.
- Për disa njerëz e futni dorën në zjarr se
- nuk do t'ju shesin kurrë, dhe në fund
- gëzoheni se keni dhe një tjetër.
- Çelësi i lumturisë është të ndalosh
- krahasimin e vetes tënde me të tjerët.
- E nesërminja nuk është gjë tjetër përveç
- se sotmja, për të cilën jemi kujdesur dje.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

